

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 16, 19.01.2024*

16.01.2024

Ora, 13:35

RENDI I DITËS

“Për shqyrtimin e kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 01, datë 08.01.2024”.

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin Lako, z. Elvis Çefa, z. Ilirjan Rusmali, z. Koli Bele, z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Y. Merkaj, znj. J. Josifi, z. E. Mema.
- **Parti Politike:** PD (z. I. Sefa), PS (z. M. Legisi)
- **Të tjerë:** Bashkia Durrës (z. A. Kaçupi, z. E. Lufo)
Bashkia Rrogozhinë (znj. E. Memolla)
Z. F. Nuri, përfaqësues i z. A. Muka

Z. E. Çefa: Mirëdita të gjithëve, deklarojmë të çelur seancën për shqyrtimin e kërkesës nr. 1, datë 8 janar 2024 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Kërkesa i është drejtuar KAS-it me propozim për vendosjen e disa sanksioneve administrative ndaj disa subjekteve politikë që janë Partia Socialiste e Shqipërisë, Partia Demokratike e Shqipërisë. Gjithashtu dhe ndaj disa kandidatëve për kryetarë bashkie në zgjedhjet e pjesshme të datës 6 mars 2022. Verifikojmë prezencën, është prezent trupa e plotë e KAS-it, është prezent Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së dhe administrata e tij, të cilët në këtë procedim do të përfaqësojnë Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve. Janë prezent, ju lutem përfaqësuesit e palëve të interesuara, ju lutem prezantohuni!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 16, 19.01.2024*

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD: Indrit Sefa, përfaqësues i Partisë Demokratike të Shqipërisë.

Z. F. Nuri, avokat për z. Ardian Muka: Avokat Franci Nuri, me prokurë të posaçme për kandidatin zotin Ardian Muka.

Z. E. Lufa, përfaqësues i znj. E. Sako: Ermal Lufa, përfaqësues i zonjës Emirjana Sako, kryetare e Bashkisë Durrës.

Z. A. Kaçupi, përfaqësues i znj. E. Sako: Alvaro Kaçupi, përfaqësues i zonjës Emirjana Sako.

Z. M. Legisi, përfaqësues i PS: Marenglen Legisi, përfaqësues i subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë me autorizim të datës së sotme, e vëmë në dispozicion.

Z. E. Çefa: Ju lutem dorëzojeni autorizimin meqenëse është hera e parë që ju vini sot.

Z. M. Legisi, përfaqësues i PS: Faleminderit i nderuar!

Znj. E. Memolla, përfaqësuese e z. E. Memolla: Erinda Memolla, përfaqësuese e zotit Edison Memolla.

Z. E. Çefa: Ju faleminderit të gjithëve! Sipas procedurës, pa humbur kohë, unë do t'i jap fjalën Sekretarit të Përgjithshëm të KQZ-së që të parashtojë kërkesën e Komisionerit në mënyrë të përmbledhur. Më pas do ta keni fjalën secili nga ju dhe

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 16, 19.01.2024*

sigurisht, eventualisht nëse do të ketë pyetje do të vijojmë më tej. Atëherë zoti Merkaj fjala për ju!

Z. Y. Merkaj: Po, faleminderit! Më datë 6 Mars 2022 u zhvilluan zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie në 6 bashki të vendit, përkatësisht në bashkitë: Durrës, Shkodër, Rrogozhinë, Lushnjë, Dibër dhe Vorë. Në këto zgjedhje u regjistruan pesë subjekte zgjedhore, nga të cilat tre parti politike me vehte dhe një koalicion. Për procesin e monitorimit të fushatës zgjedhore, u caktuan njëzet monitorues të fushatës zgjedhore për këto gjashtë bashki. Monitoruesit dorëzuan në KQZ 60 (gjashtëdhjetë) raporte monitorimi. Nga këto shtatë ishin me shkelje dhe janë miratuar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve gjetjet e këtyre raporteve.


Në lidhje me shkeljet:

Shkelja e pretenduar në bazë nenit 23/4, pika 3, të ligjit “Për Partitë Politike”, Partia Socialiste e Shqipërisë ka deklaruar si zyra zgjedhore katërmbëdhjetë të tilla, nga raportet e monitoruesve rezulton se ka pasur në funksion tridhjetë e gjashtë zyra zgjedhore dhe konkretisht:

- 7 zyra zgjedhore në Bashkinë Shkodër;
- 21 zyra zgjedhore në Bashkinë Durrës;
- 3 zyra zgjedhore në Bashkinë Lushnje;
- 2 zyra zgjedhore në Bashkinë Rrogozhinë;
- 1 zyrë zgjedhore në Bashkinë Vorë;
- 2 zyra zgjedhore në Bashkinë Dibër.

Lidhur me shpenzimet për mediat sociale Partia Socialiste e Shqipërisë ka deklaruar se ka shpenzuar 39 600 (tridhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind) lekë, nga verifikimet konstatohet se:

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 16, 19.01.2024*

Kandidati i bashkisë Dibrër ka shpenzuar 16 386 (gjashtëmbëdhjetë mijë e tetëdhjetë e gjashtë) lekë;

Kandidati I bashkisë Lushnje ka shpenzuar 14 867 (katërmëdhjetë mijë e tetëdhjetë e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë;

Kandidati i bashkisë Rrogozhinë ka shpenzuar 14 867 (katërmëdhjetë mijë e tetëdhjetë e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë;

Kandidati i bashkisë Vorë ka shpenzuar 13 022 (tremëdhjetë mijë e njëzet e dy) lekë;

Kandidatja e bashkisë Durrës ka shpenzuar 33 098 (tridhjetë e tre mijë e nëntëdhjetë e tetë) lekë;


Kandidatja e bashkisë Shkodër ka shpenzuar 44 601 (dyzet e katër mijë e gjashtëdhjetë e një) lekë

Në total për mediat sociale nga kandidatët për kryetarë bashkie të Partisë Socialiste e Shqipërisë janë shpenzuar 136 841 (njëdhjetë e gjashtë mijë e tetëdhjetë e dyzet e një) lekë, shumë larg nga deklarimi i Partisë Socialiste, 39 600 (tridhjetë e nëntë mijë e gjashtëdhjetë) lekë.

Në lidhje me shkeljet e pretenduara, nga Partia Demokratike, në bazë të nenit 23/4, pika 3, të ligjit “Për Partitë Politike”. Nga verifikimet e bëra me raportet e monitoruesve rezulton se kjo parti ka pasur në funksion tridhjetë e tre, zyra zgjedhore dhe konkretisht:

- 11 zyra zgjedhore në Bashkinë Shkodër;
- 13 zyra zgjedhore në Bashkinë Durrës;
- 2 zyra zgjedhore në Bashkinë Lushnje;
- 3 zyra zgjedhore në Bashkinë Rrogozhinë;
- 2 zyra zgjedhore në Bashkinë Vorë;
- 2 zyra zgjedhore në Bashkinë Dibër.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 16, 19.01.2024*

Nga raportet e monitorimit rezulton se këta nuk kanë deklaruar asnjë zyrë zgjedhore.

Në lidhje me shpenzimet për mediat sociale, Partia Demokratike ka deklaruar se nuk ka pasur shpenzime, në fakt nga historiku i mediave sociale (Facebook) rezulton se: Kandidati për kryetar i bashkisë Lushnje ka shpenzuar 7 596 (shtatë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë;

Kandidati për kryetar i bashkisë Durrës ka shpenzuar 98 102 (nëntëdhjetë e tetë mijë e njëqind e dy) lekë;


Kandidati për kryetar i bashkisë Shkodër ka shpenzuar 83 668 (tetëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë.

Në total për mediat sociale Partia Demokratike, ka shpenzuar 189 366 (njëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë. 5.000.000 lekë ose/dhe me pezullimin deri në 5 vjet të financimit publik për partinë politike.

Në lidhje me shkeljen e pretenduar në bazë nenit 173, pika 3 e Kodit Zgjedhor, Partia Demokratike ka dorëzuar raportin financiar për fushatën zgjedhore jashtë afatit të përcaktuar në nenin 92/3, pika 1, e Kodi Zgjedhor, si dhe nuk ka dorëzuar raportet për pesë kandidatët për kryetarë bashkie të datës 6 mars 2022.

Gjithashtu në shkeljen e pretenduar në bazë nenit 173, pika 8 të Kodit Zgjedhor, KQZ-ja, ka kërkuar të dhëna dhe informacione nga Partia Demokratike, në bazë të nenit 92/6 të Kodit Zgjedhor. Partia Demokratike nuk i ka kthyer përgjigje kërkesës së KQZ-së. Në bazë të nenit 92/6, pikës 6 përcaktohet se: “KQZ-ja në zbatim të këtij neni ka të drejtë të kërkojë të dhëna, informacione, apo dokumenta nga subjektet zgjedhore, apo persona të tretë, të cilët duhet t’i përgjigjen kërkesës së KQZ-së brenda 15 ditëve. Mosbashkëpunimi ose refuzimi për të bashkëpunuar, asgjësimi i dokumenteve, vonesat ose sjellja e papërshtatshme në procesin e verifikimit të kryer nga KQZ-ja raportohet në prokurori si vepër penale, sipas nenit 248 të Kodit Penal,

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 16, 19.01.2024*

si dhe ndëshkohen administrativisht prej saj në përputhje me nenin 173, të Kodit Zgjedhor”.

Në lidhje me shkeljet nga kandidatët për kryetarë bashkie të datës 6 mars 2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka zhvilluar një seancë në datën 6 Tetor 2023, para zhvillimit të seancës publike, nga organizata KRIIK është pretenduar se nga katër kandidatët nuk kanë deklaruar dhurime të bëra në llogaritë e tyre mbi pesëdhjetë mijë lekë e cila është shkelje. Pasi u verifikuan, rezultoi se këta kandidatë kanë pranuar dhurime me vlerë më të madhe se 50 000 lekë në llogaritë e tyre. Më konkretisht:

Zonja Emirjana Sako, në raportin e saj si kandidate e subjektit zgjedhor “Partia Socialiste” i ka dhuruar vetes 92 775 lekë *cash*.

Zoti Edison Memolla, në raportin tij si kandidat i subjektit zgjedhor i Partisë Socialiste i ka dhuruar vetes 120 590 lekë *cash*.


Zoti Ardian Muka, në raportin e tij si kandidat i Koalicionit “Shtëpia e Lirisë”, i ka dhuruar vetes shumën 415 000 lekë *cash*.

Zoti Bardh Spahia, në raportin e tij si kandidat i Koalicionit “Shtëpia e Lirisë”, i ka dhuruar vetes 91 420 lekë *cash*.

Bazuar në nenin 173, pika 5, të Kodit Zgjedhor “... Pranimi i fondeve private me vlerë më të madhe se 50 mijë lekë përmes formave të tjera, të ndryshme nga kalimi në llogarinë bankare, dënohet me gjobë të barabartë me shumën e dhuruar si dhe kalimin e fondeve të marra në KQZ”.

Në përfundim të shqyrtimit të raporteve të auditimit të dorëzuara nga subjektet zgjedhore, duke marrë në konsideratë problematikat e evidentuara gjatë shqyrtimit administrativ, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vendosi:

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 16, 19.01.2024*

T'i propozojë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për Partinë Socialiste të Shqipërisë, gjobë në vlerën 3 000 000 (tre milion) lekë, sipas nenit 23/4, pika 3 të ligjit “Për Partitë Politike”;

T'i propozojë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për Partinë Demokratike, gjobë në vlerën 3 000 000 (tre milion) lekë, sipas nenit 23/4, pika 3 të ligjit “Për Partitë Politike”;

T'i propozojë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për “Partinë Demokratike”, gjobë në vlerën 500 000 (pesëqind mijë) lekë, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor;

T'i propozojë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për “Partinë Demokratike”, gjobë në vlerën 100 000 (njëqind mijë) lekë, sipas nenit 173, pika 8 të Kodit Zgjedhor;

T'i propozojë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për kandidaten për kryetare bashkie të Partisë Socialiste të Shqipërisë, zonjën Emirjana Sako, gjobë në vlerën 92 775 lekë e cila është vlera që ka kaluar jashtë llogarisë bankare të kësaj kandidateje;

T'i propozojë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për kandidatin për kryetar bashkie të Partisë Socialiste të Shqipërisë, për Bashkinë Rrogzhinë, zotin Edison Memolla, gjobë në vlerën 120 590 lekë;

T'i propozojë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për kandidatin për kryetar bashkie të Koalicionit “Shtëpia e Lirisë”, zotin Bardh Spahia, gjobë në vlerën 91 420 lekë;

T'i propozojë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për kandidatin për kryetar bashkie të Koalicionit “Shtëpia e Lirisë”, zotin Ardian Muka, gjobë në vlerën 415 000 lekë.

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 16, 19.01.2024*

Bashkëlidhur keni vendimin e Komisionerit për miratimin e raportit të gjetjeve si dhe raportin e gjetjeve, faleminderit!

Z. E. Çefa: Ju faleminderit zoti Merkaj! Ju lutem përfaqësuesve të palëve të interesuara sipas rradhës duke filluar nga zoti Sefa, që të parashtroni dhe ju kundërargumentat tuaja kundër këtij propozimi të Komisionerit.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD: Po i nderuar, Partia Demokratike nuk ka deklaruar zyra zgjedhore, sepse nuk ka pasur zyra zgjedhore për zgjedhjet e 6 marsit. Unë flas me bindje për raportin që ka bërë KQZ-ja që thotë “në Lushnje ka pas dy zyra zgjedhore”. Ne kemi pasur vetëm selinë e Partisë Demokratike në Lushnje, patjetër që ka pasur banderola dhe printime në ambjentet e bizneseve të ndryshme, por nuk ka funksionuar si zyrë zgjedhore. Ne në konceptin tonë nuk kemi pas detyrim për të deklaruar një ambjent në të cilin nuk ushtrohet aktivitet politik si zyrë zgjedhore. Duke pasur parasysh edhe rregullat dhe Kodin Zgjedhor për mënyrën e afishimit të banderave dhe të materialeve propagandistike është e vështirë tanimë që të bëhen në mënyrë publike, ose në vende të papërcaktuara nga pushteti vendor, jemi detyruar që të përshtatemi në ambjente të tilla. Me sa shoh KQZ-ja ka parë vetëm afishimin e këtyre materialeve propagandistike, ose printimin e tyre në ambjente dhe sipërfaqe të bizneseve private dhe e ka marrë të mirëqenë sikur janë zyra për qëllime elektorale, sikur janë zyra elektorale. Unë nuk shoh asnjë provë nga ana e KQZ-së për të vërtetuar pretendimin e tij. Gjithashtu thotë për “zyra zgjedhore”. Duhet të kuptojë që mënyra e organizimit dhe funksionimit të partive politike, në atë kohë ka qenë e ndarë në grup-seksione, seksione dhe degë. Normalisht çdo njësi administrative ka qenë më së paku me dy ose tre grup-seksione. Çdo grup-seksioni ka dhe vendin ku ushtron aktivitetin e tij politik. Kjo nuk do të thotë që është zyrë

*Zbardhi materialin audio
Merița DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 16, 19.01.2024*

elektorale. Unë nuk e di që këto të kenë funksionuar si zyra elektorale. Unë kam marrë konfirmimin dhe nga kolegët, nga partia dhe nuk ka pasur zyra elektorale në dijeninë tonë, që të kenë qenë në funksion të zgjedhjeve të 6 marsit. Janë vetëm ambjentet ku ka selitë Partia Demokratike, por dhe ambjente të cilat janë përdorur me qëllim vetëm afishimin e materialeve propagandistike. Ato vishen me adeziv dhe shërbejnë vetëm për këtë qëllim. Në lidhje me sa thashë më sipër, ky është dhe shpjegimi ynë pasi nuk shohim dhe aktivitete. Nuk e di, mbase Komisioni Qendror i Zgjedhjeve e ka vërtetuar që ushtrohet aktivitet politik në këto zyra, apo e ka marrë vetëm nga ana e fasadës. Gjë tjetër që mjafton të përmend, lidhet me faktin që janë dorëzuar jashtë afatit. Është e vërtetë që janë dorëzuar jashtë afatit. Duhet të kuptojmë situatën në të cilën ndodhej Partia Demokratike në muajt mars, prill. Ka pasur problematika të brendshme në Partinë Demokratike që kanë bërë realisht të pamundur dhe administrimin e të gjithë dokumentacionit që ne kemi pasur aty, në seli. Megjithëse jemi munduar për të mbledhur të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, ne e kemi dorëzuar raportin jashtë afatit, e pranojmë, nuk kemi pse ta mohojmë. Ju e dini që ka pasur., në datën 25 mars, përfundimisht ne si subjekt, për arsyet tona të brendshme nuk kishim më disponimin e selisë qendrore. Aksesit i dokumentacionit që kishim në arkivë, na humbi atë ditë. Çfarë jemi munduar në kushte vështirësie kemi arritur t'i marrim dhe të dorëzojmë materialin për aq sa mundemi. Ky është... unë e kuptoj që ju doni një arsye ligjore për këtë, por u tregova shumë i sinqertë dhe arësyen e drejtë se çfarë ka ndodhur. Ndërsa për mosdorëzimin e raporteve të kandidatëve, varjon me të njejtën arsye. Kishim vështirësitë tona organizative dhe patjetër që nuk i kemi dorëzuar dhe ato, pavarësisht se shpenzimet, siç janë raportuar edhe nga raporti që është paraqitur nga Partia Demokratike dhe nga ajo ç'ka pasqyruar sot KQZ-ja, relatojnë fare qartë se kemi të bëjmë me shpenzime që janë përballuar nga fondet e vetë subjektit zgjedhor. Ka dhe raporte të


*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 16, 19.01.2024*

detajuara për shpenzimet që ka kryer. Pjesa më e madhe e këtyre shpenzimeve janë nga kontrata që kanë me agjencinë e reklamimit dhe prodhimit të materialeve propagandistike. Këto janë argumentat tanë. Për ta quajtur një zyrë elektorale, patjetër që duhet të kishte prova që të tregonte se aty me të vërtetë zhvillohet aktivitet politik. Patjetër që kemi zhvilluar aktivitet politik, në selitë e partisë politike, të Partisë Demokratike. Unë në Lushnje kam qenë kandidat më 6 mars. Kam zhvilluar aktivitet politik në selinë e Partisë Demokratike. Selia e Partisë Demokratike ndodhet në qendrën e qytetit që ka referuar në Rajonin nr. 2, është Njësia Administrative nr. 2 dhe është Lagjja Kongresi... aty është selia e Partisë Demokratike. Ne aty ushtrojmë aktivitet politik të përditshëm. Nuk është zyrë elektorale, është selia e subjektit zgjedhor. Siç kemi, në çdo njësi administrative, kemi njësi administrative, ku kryetari i njësisë administrative, kryetari i partisë, në atë rast i grup-seksionit merr masa për të organizuar aktivitetin e tij politik. Po ato nuk janë zyra elektorale, nuk hapen vetëm për qëllimin e aktivitetit në kohën që bëhet procesi zgjedhor. Ato janë të përhershme në pjesën më të madhe të tyre, janë të përhershme. Aty organizohet në mënyrë kapilare dhe subjekti zgjedhor dhe partia politike. Këto janë pretendimet tona.

Z. E. Çefa: Kam një propozim, do të bëjmë një ndryshim të vogël. Mendoj që për efekt dhe të ekonomisë së procesit, të dëgjojmë dhe përfaqësuesin e Partisë Socialiste, i cili, besoj do të ketë prapësime për konstatimet e të njëjtit karakter. Bëjmë debatin dhe pyetjet për këtë problematikë dhe pastaj vijojmë me kandidatët. Në mënyrë që dhe ne ta kemi pak më të freskët edhe kujtesën. Besoj jeni dakord të gjithë, apo jo?! Dakord! Përfaqësuesi i Partisë Socialiste!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 16, 19.01.2024*

Z. M. Legisi, përfaqësues i PS: Faleminderit i nderuar! Sipas edhe kërkesës së depozituar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, i është propozuar Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, siç referoi dhe Sekretari i Përgjithshëm, ndëshkimi me masë tre milion lekë, sipas nenit 23/4, pika 3 e ligjit “Për Partitë Politike”, që lidhet me mungesën e transparencës për financat. Dispozita konkrete flet për refuzim të subjektit. Nga përmbajtja e vendimit ka rezultuar që subjekti që përfaqësoj ka dorëzuar raporte financiare dhe ka bërë sa kërkohej dhe sikurse e ka vlerësuar ai situatën e tij në atë kohë, në raport me zgjedhjet e pjesshme vendore. Ka depozituar një raport financiar brenda afatit ligjor, po ashtu ka depozituar edhe numrin e zyrave elektorale. Tani, sa i përket zyrave është konstatuar, sipas Komisionerit Shtetëror, një numër më i madh se ai i deklaruar. Është një situatë që në vlerësimin tonë nuk qëndron, pasi edhe argumenti është i njëjtë me atë të kolegut Sefa më parë. Zyrat elektorale në vlerësimin e Partisë Socialiste janë ato që kemi deklaruar, ndërsa të tjerat nuk janë zyra elektorale, por janë zyra ekzistuese të Partisë Socialiste për zhvillimin e jetës politike në mënyrë të vazhdueshme dhe jo për një periudhë të caktuar kohore. Nuk ka pasur aktivitet elektoral për sa pretendohet nga ana e Komisionerit. Ky është qëndrimi ynë në lidhje me këtë pikë. Për sa i përket pjesës tjetër, të reklamave në media, janë disa media të cilat janë pak të njohura nga ana jonë. Partia Socialiste nuk ka pasur asnjë marrëveshje, as në formë të shkruar, as në formë të pa shkruar. Janë disa media, le të themi periferike, që nuk ka as interes subjekti ynë për të kontraktuar media të tilla, pasi media kombëtare e mbulon territorin e nuk ka nevojë për të kontraktuar media të tilla për fushata zgjedhore. E ftoj komisionin që edhe në lidhje me këtë pjesë, edhe mediat nuk është se e kanë të ndaluar që të bëjnë një fushatë, që të mbajnë krahun e një partie politike, qoftë në zgjedhje vendore, qoftë në zgjedhje të përgjithshme.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 16, 19.01.2024*

Z. E. Çefa: Nuk dua t'ju ndërpres, por thjesht në raport, të paktën për sa i përket kësaj pike që po trajtojmë, diskutohet vetëm për mediat sociale. Pra, për shpenzimet në mediat sociale, nuk keni nevojë të argumentoni pjesën e mediave audiovizive. Propozimi, apo konstatimi, konkluzioni i Komisionerit, ka ardhur si pasojë e konstatimit të shpenzimeve mbi deklarinimin vetëm për mediat sociale.

Z. M. Legisi, përfaqësues i PS: Po dakord, faleminderit! Është e njejta logjikë, i nderuar! Nuk është se ka një qëndrim të ndryshëm, për sa i përket mediave sociale, apo medias vizive. Komisioneri ka vënë një gjobë mjaft të lartë dhe ka zgjedhur pikën 3, të nenit 23/4 të ligjit “Për Partitë Politike”. Ne na thuhet që “ju keni refuzuar”. Faktikisht refuzimi, duke analizuar tërësinë e dispozitës është shkelja më flagrante e ligjit “Për Partitë Politike”. Partia Socialiste, sigurisht që me sjelljen e saj dhe trajtuar nga Komisioneri, nuk mund që veprimet e saj, në lidhje me këtë pjesë, nuk mund të kualifikohen aspak si refuzim dhe shkelje flagrante e ligjit. Në çdo rast ajo është treguar bashkëpunuese, nuk ka fshehur, nuk ka tentuar të fshehtë. Gjithmonë kur është kërkuar ka raportuar, por nëse në vlerësim të Komisionerit nuk është raportuar në mënyrë të plotë dhe ky konsiderohet si refuzim, për mendimin tonë, nuk jemi në këto kushte. Pra, nuk ka një refuzim nga subjekti ynë dhe që të ndëshkohet me një masë gjobe kaq të madhe, duke pasur parasysh edhe natyrën e zgjedhjeve specifike, në këtë periudhë kohore.

Z. I. Rusmali: Të sqarojmë këtë të fundit! Ju thoni që nuk jemi përpara shkeljes “refuzimit” që thotë ligji. Përpara cilës situatë jemi?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 16, 19.01.2024*

Z. M. Legisi, përfaqësues i PS: Nëse ka një sjellje që bie në kundërshtim me ligjin, atëherë në vlerësimin tonë, kjo quhet shkelje e ligjit. Shkelje e dispozitave të ligjit për financimin, por nuk mund të konsiderohet refuzim.

Z. I. Rusmali: E cilës dispozitë konkrete?

Z. M. Legisi, përfaqësues i PS: Neni 23/4, pika 1. Refuzimi është një flagrancë, është një arrogancë e subjektit zgjedhor. Pra, le të themi kur ka një investigim dhe pastaj tenton të fshehë, nuk bën, nuk deklaron.., në këtë kuptim e kam, i nderuar! Nuk ka një refuzim.

Z. K. Bele: Më fal, po këtu dua të sqarohem edhe unë, sepse duke lexuar ligjin në kuptimin, kur ju thoni “refuzim”, e kam më shumë për Yllin dhe mund ta plotësojë dhe përfaqësuesi i subjektit, do të thotë që është kontaktuar subjekti dhe ka refuzuar të përgjigjet, apo të saktësojë deklarin, apo ta plotësojë? Apo fakti që është konstatuar një papajtueshmëri është barazuar me refuzimin? Këtë dua të sqaroj!

Z. Y. Merkaç: Po, fakti që është konstatuar papajtueshmëri është konsideruar si refuzim i partisë për të bashkëpunuar me KQZ-në dhe për të bërë transparente burimet e fushatës.

Z. K. Bele: Pra, ju e barazoni me refuzimin. Po këtë, desha të kuptoj se nuk e njoh me detaje procesin e auditimit, se si funksionon dhe ndoshta raporti është pak a shumë, të paktën ai që kemi ne e njejta gjë me vendimin e Komisionerit. Audituesit i ftojnë subjektet të bëjnë saktësime, apo plotësime, apo shpjegime?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 16, 19.01.2024*

Z. Y. Merkaj: Audituesi caktohet nga KQZ-ja me short. Në bazë të shortit të rënë, audituesit i caktohet partia. Audituesi me të marrë detyrën kontakton me përfaqësuesin ose financierin e partisë, varet cili është personi i kontaktit dhe bashkëpunojnë. Kanë 30 ditë afat për të bërë raportin, kështu që është në kontakt të vazhdueshëm.

Z. K. Bele: Ne kemi gjurmë të këtij dialogu, që ka kërkuar të dhëna shtesë, apo jo? janë plotësuar, apo janë refuzuar?

Z. Y. Merkaj: Ideja është që audituesi është procesi i fundit i identifikimit të problematikave. Raporti i parë është raporti i monitoruesve. Raporti i dytë është raporti që vetë partia politike dorëzon në KQZ dhe pastaj është raporti i audituesit. Të tre këto raporte gërshetohen dhe dalin problematikat.

Z. K. Bele: Për ta përmbledhur, nëse e kuptova drejt, ..

Z. Y. Merkaj: Bëhet një kryqëzim midis të dhënave që ka sjellë monitoruesi, raportimet që ka bërë partia politike vetë te raporti që i dorëzon KQZ-së dhe audituesi që i auditoron të dyja këto raporte.

Z. K. Bele: Pra, ju nuk e dini me saktësi natyrën e dialogut që zhvillohet midis tyre. Monitoruesi thotë “në njësinë zgjedhore, administrative janë dy zyra të subjektit “x”. Subjekti politik ka deklaruar një. Tani ky momenti se e lidh dhe me sqarimin e zotit Sefa, për këtë moment, a bëhet një hetim dhe një sqarim? Kemi pas dikur dhe raste të tjera...

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 16, 19.01.2024*

Z. Y. Merkaj: Bëhet se monitoruesi gjatë procesit të monitorimit raporton në KQZ me raporte të ndërmjetme.

Z. K. Bele: Jo, jemi tek audituesi. Ka një dialog midis audituesit dhe subjektit që të sqarojë këtë element?

Z. Y. Merkaj: Më shumë sheh verifikimin e dokumentacionit.

Z. K. Bele: Pra, monitorimi bëhet vetëm pas faktit mbi letra?

Z. Y. Merkaj: Po dhe sheh të dy raportet, pra audituesi monitoron letrat që ka partia politike dhe monitoruesi.

Z. K. Bele: Dakord, faleminderit!

Z. L. Braho: Monitoruesi është një person, apo është grup?

Z. Y. Merkaj: Për zgjedhjet e 6 marsit, që kanë qenë 6 bashki, janë caktuar 20 monitorues për të gjitha bashkitë, në bazë të sipërfaqes së banimit...

Z. L. Braho: Po, tani në Bashkinë Lushnje, sa monitorues kanë qenë dhe këta funksionojnë dy, ose më shumë, apo me zona? Në qoftë se janë tre monitorues në Lushnje, secili ka në zonë të caktuar?

Z. Y. Merkaj: Po, secili monitorues ka një zonë të caktuar më vehte dhe bëjnë raportet për zonën përkatëse.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 16, 19.01.2024*

Z. L. Braho: Pra, fati i fushatës së një partie politike, me pak fjalë, varet nga raporti i monitoruesit.

Z. Y. Merkaj: Jo nuk varet, pse varet fati?

Z. L. Braho: Po pra, se monitoruesi çon në kohë reale...

Z. Y. Merkaj: Monitoruesi është kontraktuar nga KQZ-ja, është emëruar nga KQZ-ja, paguhet nga KQZ-ja, kështu që...

Z. L. Braho: Nuk po diskutojmë pjesën e pagës së monitoruesit...

Z. Y. Merkaj: ... nuk mund ta vemë në dyshim raportin e monitorimit.


Z. L. Braho: Pse nuk e ve në dyshim? Ai momenti që çon këto raportet e ndërmjetme, ka ndonjë lloj ballafaqimi me subjektin zgjedhor, ose më saktë, ka ndonjë lloj shkëmbimi informacioni, të paktën për këto pretendime që po ngrenë dy subjektet zgjedhore?

Z. Y. Merkaj: Jo nuk ka!

Z. L. Braho: Këta thonë që nuk kemi pas zyrë elektorale, monitoruesit thonë që keni pasur zyra elektorale.

Z. Y. Merkaj: Ky debat nuk është bërë, tani po bëhet për herë të parë.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 16, 19.01.2024*

Z. L. Braho: Me sa kujtoj edhe në zgjedhjet e 14 majit, patëm një rast të ngjashëm me selinë e një subjekti, që ishte konsideruar si zyrë elektorale dhe rezultoi se ishte selia rajonale e një subjekti zgjedhor. Kush e bën verifikimin e kësaj?

Z. Y. Merkaj: Atëherë, monitoruesi sheh në terren cilat janë zyrat elektorale. Sheh të gjitha zyrat që janë vendosur pankartat e partisë, emrat e kandidatëve, fotografitë e kandidatëve ndoshta. Ai këtë bën monitorimin, e fotografon thotë që “kjo është në kundërshtim.., pra, janë këto zyra 1, 2, 3, 4, 5” dhe i sjell në KQZ, Nuk bën debat me partitë politike.

Z. L. Braho: Nuk e verifikon askush këtë procesin e raportimit?

Z. Y. Merkaj: Po i shohim, na i ka sjellë me foto ai këto. Kjo zyrë, është Indrit Sefa aty me fotografi afër një zyre. Ajo zyrë është elektorale.

Z. L. Braho: I keni ju këto, të gjitha këto?

Z. Y. Merkaj: Po, i kemi fotografitë!

Z. L. Braho: I kanë subjektet zgjedhore këto prova?

Z. Y. Merkaj: Po, ua dhamë sot!

Z. K. Bele: Nuk dua t’i ndërhyj Ledios, po si kuptohet... ka individë që vendosin dhe në taksi, venë shalla, disa kanë bërë dhe tatuazhe kanë dalë në televizor, që vendosin

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 16, 19.01.2024*

kandidatin, flamurin në oborr. Si verifikohet që te një zyrë që është bosh dhe ai tipi ka vënë ato banderolat, si verifikohet që është individi, është subjekti. Ka një moment që bëhet ky hetim?

Z. L. Braho: Dhe pjesa tjetër, ku rregullohet ky procesi i monitorimit, se duhet të ketë një bazë ligjore besoj për mënyrën...

Z. Y. Merkaç: Tek udhëzimi nr. 6 i KSHZ, i cili ka përcaktuar se kush janë zyrat elektorale, se si përcaktohet vendndodhja e tyre dhe kriteret..,

Z. L. Braho: Jo, jo procedura se si funksionon monitoruesi, se ato i dimë.

Z. Y. Merkaç: Po ka një vendim që është për hedhjen e shortit, si hidhet shorti dhe si funksionon dhe detyrat që ka monitoruesi.

Z. E. Lako: Meqenëse jemi këtu te kjo shkelje e këtyre dy partive që raportuan këtu, një sqarim nga zoti Sekretar i Përgjithshëm. E para njëherë, për pjesën e monitorimit, siç e thanë dhe kolegët, duhet të ketë një krahasim, se çfarë kanë nxjerrë monitoruesit dhe duhet të ketë një korespondencë me partitë politike, se cilat janë ato që pretendohet se nuk janë zyra elektorale. Siç u raportua nga zoti Sefa që psh një zyrë është zyrë e subjektit politik që e kanë gjatë gjithë vitit. Aty është selia e partisë pra, nuk është zyrë elektorale, ju e konsideroni dhe atë gjatë periudhës zgjedhore si zyrë elektorale dhe duhet raportuar? Pra, duhet bërë një sqarim dhe një krahasim. A është bërë kjo gjë, apo jo? E dyta, për sa i përket gjobës së propozuar nga Komisioneri, mbështetet në nenin 23/4, pika 3 ku nuk flet fare për monitoruesit, por flet për pjesën e refuzimit që ka bërë subjekti për të bërë transparent burimet e financimit, apo

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 16, 19.01.2024*

mosbashkëpunimin me ekspertin kontabël. Pra, eksperti kontabël është ai tani që duhet të bashkëpunonte me subjektin, siç e kuptoj unë, këtë pikë të këtij neni dhe këtu duhet të ketë ndodhur ndonjë refuzim nga subjekti për të bërë këtë raportim që është kërkuar nga eksperti. Pra, jemi te faza e ekspertit tani me gjobën e propozuar. Ka ndodhur kjo kërkesë nga ana e ekspertit dhe refuzimi nga ana e subjektit. Apo thjesht nëpërmjet monitoruesit ju keni dalë në konkluzionin që nuk është raportuar burimi i financimit për këto zyra elektorale të supozuara, që janë zyra elektorale?

Z. Y. Merkaç: Kryesisht jemi bazuar te raporti i monitorimit. Siç thashë dhe më parë, raportet janë të ndërmjetme. Ka tre-katër raporte nga momenti i emërimit të monitoruesit, deri në momentin përfundimtar. Nuk bëhet fjalë vetëm për Lushnjën, këtu kemi 21 zyra zgjedhore në Bashkinë Durrës. 11 zyra zgjedhore janë në Bashkinë Shkodër...

Z. E. Lako: Po pra, neni ku ju keni propozuar vendosjen e gjobës është i qartë, më lejoni ta lexoj “refuzimi për të bërë transparent burimet e financimit të partisë politike ..”, se flasim te pjesa e financimit, “... apo për të lejuar ushtrimin e kontrollit nga ana e ekspertit kontabël të licensuar, nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve”. Pra, ky ekspert kontabël për të bërë këtë verifikim, duhet të bënte një kontroll, apo jo?

Z. Y. Merkaç: Nuk jemi tek eksperti. Është thjesht...

Z. E. Lako: Jemi te pika 3 e nenit 23/4...

Z. Y. Merkaç: Nuk kanë bërë transparent burimin e financimit...

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 16, 19.01.2024*

Z. E. Lako: Po, pra, por është një e gjitha ajo, “apo”?

Z. Y. Merkaj:...“apo”, po është...

Z. E. Lako: Si e keni provuar që nuk e ka bërë transparent burimin e financimit?
Si?!

Z. Y. Merkaj: Sepse partia ka deklaruar 2 zyra zgjedhore, në fakt ajo ka hapur 12
zyra zgjedhore. zyrat zgjedhore mbahen me lekë...

Z. E. Lako: Këtë faktin si e keni provuar ju?

Z. Y. Merkaj: Pagesat e zyrave zgjedhore nuk i ka bërë transparente në raportin e
partisë. Kjo është ideja. Partia vërtet thotë që nuk kam harxhuar asnjë lek për
fushatën zgjedhore. Në fakt ajo ka hapur 33 zyra zgjedhore.

Z. E. Lako: Këtë faktin po kërkojmë. Si e keni provuar ju këtë fakt?

Z. Y. Merkaj: Me monitoruesit, prandaj caktohen monitoruesit, i emëron KQZ-ja
dhe caktohen.. të gjitha raportet e monitorimit shoqërohen me foto, si dhe thonë
vendndodhjen. Ke një raport, mund të shohim një raport në qoftë se dëshironi...

Z. E. Çefa: Zoti Merkaj, që të vazhdoj logjikën e kolegut. Ju e keni përkthyer numrin
e zyrave në një shumë të caktuar të hollash, e cila nuk ju rakordon me deklarin e
subjektit dhe për këtë arsye keni referuar në këtë nen, apo jo?!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 16, 19.01.2024*

Z. Y. Merkaç: Qëllimi i raportimit të partisë politike është që të bëjë transparente financat e saja...

Z. E. Çefa: Sigurisht!

Z. Y. Merkaç: Unë kam hapur dy zyra, tre zyra. Për këto zyra paguaj qiranë 150-200 mijë lekë në muaj. Partia deklaron 2 zyra, në fakt ka hapur 12 zyra. Pjesa tjetër nuk është transparente.

Z. E. Çefa: Që ju të arrini në konkluzionin që nuk janë bërë transparente fondet, duhet që secilës zyrë t'i përcaktoni një buxhet, apo jo? Se mund të thotë... në vetvehte tejkalimi i numrit të zyrave të deklaruara, nuk është shkelje në vetvehte, por ama paratë që i koorespondojnë numrit më të madh të zyrave, sjell si pasojë tejkalimin e buxhetit që ka deklaruar partia. Për këtë arsye sanksionohet, apo jo?

Z. Y. Merkaç: Po!

Z. E. Çefa: Në këtë kuptim tani, ju çfarë peshe specifike, në të holla i keni dhënë secilës zyrë dhe si e keni bërë këtë, në mënyrë që të arrini në këtë konkluzion, sepse partia mund të thotë sot, "dakord kam dhe më tepër zyra, por buxhetin e kam pasur të njejtë, aq sa kam deklaruar, nuk kam shpenzuar asnjë lek më tepër. Të dyja zyrat bashkë i ka mbajtur një person, na i ka dhënë pa qira, s'kemi shpenzuar lekë, etj., etj..". Pra, një situatë hipotetike, a më kupton? Që ju tani të rrëzoni këtë argument duhet të buxhetoni secilën zyrë dhe t'i thoni "për këtë zyrë keni shpenzuar kaq lekë shumëzim 30, bëjnë kaq lekë, ndërkohë që ti ke deklaruar më pak". Ekziston një krahasim i tillë, një llogari e tillë e bërë nga ju?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 16, 19.01.2024*

Z. Y. Merkaj: Atëherë, krahasimimi bëhet kështu. Nga raporti që sjell partia politike, po qëndrojmë te zyrat se ka dhe shumë elementë të tjerë, por po marrim zyrat zgjedhore. Ajo thotë “kam marrë dy zyra zgjedhore, në “x” vend dhe “y” vend, me qera mujore kaq ,për katër muaj, sa e hapin ato. Zyrat e tjera, sikur dhe 1 lek më tepër të jetë një zyrë tjetër, ose të mos e deklarojë, ose të thotë që këtë zyrë e kam marrë pa lekë, KQZ-ja e konsideron që nuk është transparent burimi i financimit, edhe sikur një lek më tepër. Nuk ka rëndësi se është 1 lek, apo 50 lekë.

Z. E. Lako: Mirë, dakord, po eksperti kontabël që do të referohet te raporti i monitorimit që thotë, në rastin e Partisë Socialiste “ka deklaruar 14 zyra zgjedhore dhe janë 36”, mos gaboj, duhet bërë një hetim. Eksperti kontabël i kërkon subjektit për diferencën e këtyre zyrave, a ka kontratë qiraje, a ka një akt si e përdorin, cili është buxheti? Kjo është bërë, po themi ne?

Z. Y. Merkaj: Nuk është bërë auditimi, do të bëhet auditimi. Nuk kemi raporte auditimi te ky, kemi vetëm raporte monitorimi dhe deklarimin e partive politike.

Z. E. Lako: Po ne a jemi këtu te auditimi?

Z. L. Braho: Kam përpara një raport monitorimi, nuk e di se çfarë qyteti është, po këtu paska fjali pa kuptim. Tani, “kam në mënyrë të përsëritur në shkollat e mesme publike”. Tani çfarë ka në mënyrë të përsëritur, ka konstatuar, s’ka konstatuar. Tani, në qoftë se vendosim gjoba tre milion lekë të reja në bazë të këtyre raporteve që i plotëson një njeri.., që këtu ka... paska dhe elementë për kallëzim penal për sa i përket detyrave që i lihet monitoruesit. Pra, subjektet zgjedhore a ofrojnë, ose japin

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 16, 19.01.2024*

para, të mira materiale, premtojnë vende pune dhe këtë e konstaton monitoruesi në një zonë të caktuar zgjedhore?

Z. Y. Merkaj: Po, në qoftë se e konstaton e raporton.

Z. L. Braho: E raporton, kaq?!

Z. Y. Merkaj: Kaq ka detyrë ai, të raportojë në KQZ.

Z. L. Braho: Po në bazë të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale, ai ka dhe për të bërë kallëzim... Tani, në qoftë se një njeri i vetëm bën gjithë këtë për një fushatë, mua më duket e tepërt që të bazohesh vetëm te këto konstatime. Pra, ai merret me autobuzat, me automjetet, me facebook-un. Po këto shpenzimet e facebook-ut si kanë dalë, këto që pretendoni ju?

Z. Y. Merkaj: Nga verifikimet e bëra në historikun e facebook-ut, e kemi thënë këtu, të rrjeteve sociale.

Z. L. Braho: Si e bëni? E bëni ju nga jashtë? Ma shpjego pak si procedurë se nuk e kam të qartë!

Z. Y. Merkaj: Po, e bën zyra. Shohin historikun e facebook-ut dhe shohin se sa janë...

Z. L. Braho: Është informacion publik ky?

Z. Y. Merkaj: Po, po!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 16, 19.01.2024*

Z. L. Braho: Pra, që mund ta konstatosh te faqja e gjithësecilit se sa ka shpenzuar?

Z. Y. Merkaj: Po, po!

Z. L. Braho: Ajo është për periudhën e fushatës, del posaçërisht për periudhën e fushatës?

Z. Y. Merkaj: Ajo është katër muaj para datës së zgjedhjeve.

Z. L. Braho: Se këtu te kjo që kam unë këtu shoh “facebook adresa zyrtare...,” thotë, “..Lulzim Basha, Luan Hoti, Grida Duma”. Tani lulzim Basha dhe Grida Duma mund të bëjnë sponsorizime gjatë gjithë vitit në facebook. Si e nxirrni ju se sa është sponsorizuar për fushatë zgjedhore?

Z. Y. Merkaj: Nuk ka rëndësi se sa e nxjerrim, ne thjesht e ka tejkualuar. Ai ka deklaruar që “unë për mediat sociale kam shpenzuar 39 000 lekë”. Në fakt ai kishte shpenzuar në bazë të historikut që kemi parë 189 000 lekë, sikur dhe 1 lek më tepër të harxhojë...

Z. L. Braho: Mirë, mund ta bëni pak më transparente të gjithë këtë procesin këtu te ne, sepse nuk kemi provat e duhura që të bazohen gjithë këto vërtetime mbi bazë të të cilave ju kërkoni të vihen këto gjoba. Pra, si i keni konstatuar këto të facebook-ut? Këto të zyrave elektorale. Të paktën për këto për të të cilat po kërkohet vendosja e gjobës.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 16, 19.01.2024*

Z. Y. Merkaç: Atëherë, KQZ-ja ka caktuar 20 monitorues për fushatën e datës 6 mars. Këta kanë dërguar 60 raporte monitorimi. Nga të 60 raportet e monitorimit të dërguara, vetëm 7 raporte janë me shkelje, të tjerat janë pa shkelje. Tani këto 7 raporte i kemi verifikuar, i janë nënshtruar procedurës administrative dhe ka rezultuar që janë vërtet shkeljet e deklaruara nga monitoruesi. Janë 60 raporte, 53 raporte nuk kanë shkelje, 7 raporte janë me shkelje. Kjo është ajo që ka bërë KQZ-ja.

Z. E. Çefa: Zoti Rusmali!

Z. I. Rusmali: Kisha unë në fakt nja dy pyetje për zotin Merkaç. Çështja që po shqyrtojmë sot ka lidhje me zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie, që ta evidentojmë këtë, të vitit 2022. Sanksionet janë dhënë në bazë të ligjit “Për Partitë Politike”, na shpjegoni dot pse? Apo ky ishte kuadri ligjor atëherë? Kodi Zgjedhor nuk kishte sanksione për këtë qëllim, për financimin.

Z. Y. Merkaç: Është bazuar propozimi i Komisionerit edhe në Kodin Zgjedhor dhe në ligjin “Për Partitë Politike”...

Z. I. Rusmali: Referencat janë te ligji “Për Partitë Politike”!

Z. Y. Merkaç: Jo! Ka dhe Kodi Zgjedhor, është neni 173 i tij, pika 5, pika 8.

Z. I. Rusmali: Dakord, po ne po diskutojmë nenin 23/4, pika 3 e ligjit “Për Partitë Politike”, si bazë ligjore për vendosjen e sanksionit. Pse nuk është një referencë “x” në Kodin Zgjedhor, sepse këto janë zgjedhje.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 16, 19.01.2024*

Z. Y. Merkaj: Kjo, sepse është marrë për transparencë të financimit të partive politike. Është konstatuar se këto fshehje, ose mosdeklarime në KQZ, kanë të bëjnë me transparencën e financimit të partive politike.

Z. I. Rusmali: Dakord, dakord, po procesi..., nuk dua ta bëj debat, procesi është proces verifikimi zgjedhësh, jo proces verifikimi, raportimi financiar, apo jo?

Z. Y. Merkaj: Janë shpenzime të partive politike për fushatë zgjedhore.

Z. I. Rusmali: Pse nuk ka referencë Kodi Zgjedhor që merret me zgjedhje, por ka referencë ligji “Për Partitë Politike” që nuk merret me zgjedhje, merret me raportimin financiar vjetor.

Z. Y. Merkaj: Ka dhe Kodi Zgjedhor, neni 92/6, pika 6...

Z. I. Rusmali: Jo jo referencë për sanksionet. Neni 23/4, pika 3 e ligjit “Për Partitë Politike”. Neni 23/4, pika 3 e ligjit “Për Partitë Politike”. Pastaj vjen kodi, kodi, kodi, kodi, kodi. Këto që janë për partitë politike, se të gjitha të tjerat janë për kandidatët. Këto për partitë politike, raportimi i partive politike është raportim zgjedhor. Pse keni marrë këtë referencë dhe jo një referencë nga Kodi Zgjedhor? Apo s’kishte kodi referencë dhe shfrytëzuar këto?

Z. Y. Merkaj: Kodi nuk ka pas referncë, ka pasur vetëm për dorëzimin e raportit nga partitë politike jashtë afatit të parashikuar në nenin 92.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt. 16, 19.01.2024

Z. I. Rusmali: KAS-i dikur në një rast tjetër jo të ngjashëm me këtë në fakt, ka mbajtur qëndrimin që në zgjedhje për pushtetin vendor, ne duhet të trajtojmë si subjekt më vehte kandidatin, sidomos në rastet kur jemi në zgjedhjet e pjesshme, pra zgjedhje vetëm për kryetar bashkie, subjekti përfitues është kandidati, jo partia politike. Unë dua të pyes, gjatë këtij hetimi që keni zhvilluar ju, e keni parë raportin kandidat-parti politike? Dmth keni bërë verifikimin, raportimin dhe shpenzimet, psh për zyrat zgjedhore. Kanë qenë të kandidatit, apo partisë politike? Duhet të ishin të kandidatit, apo të partisë politike? Këtë lloj dallimi midis kandidatit-subjekt zgjedhor dhe partisë politike-subjekt zgjedhor. Në këtë rast e keni bërë, apo nuk ka pas rëndësi për ju?


Z. Y. Merkaç: Po e kemi bërë, edhe te raporti që kemi kërkuar, ose dhe te trajnimet që janë bërë me financierët e partive politike dhe me kandidatët është thënë. Kemi dhe një model standard të dorëzuar partive politike që është detyrimi ligjor që të deklarojnë të dyja, edhe partia politike, edhe kandidati për shpenzimet e tyre.

Z. I. Rusmali: Dakord, por në rastin konkret, zyrat zgjedhore pse nuk janë shpenzime të kandidatit, por janë shpenzime të partisë politike? Bëhet fjalë për tek Partia Socialiste.

Z. Y. Merkaç: I kemi vënë dhe kandidatëve...

Z. I. Rusmali: Jo kandidatët kanë median sociale. Tani, gjoba i vihet partisë politike për zyra zgjedhore të padeklaruara, nuk po merrem me referencën e saktë, apo e gabuar, nuk po e bëj atë debat, por po bëj ngjarjen. Pra, gjoba i vihet partisë politike, nuk i vihet kandidatit.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 16, 19.01.2024*

Z. Y. Merkaj: Partisë, sepse kandidati ka disa aspekte të tjera...

Z. I. Rusmali: Pra, ju e keni hetuar dhe ju ka rezultuar që shpenzimi për zyrat elektorale i takonte partisë dhe jo kandidatit.

Znj. J. Josifi: Ju pyetët që në fillim se çfarë janë zyrat zgjedhore, ose ku e kemi këtë përcaktim...

Z. I. Rusmali: Jo, unë nuk e bëra këtë pyetje.

Znj. J. Josifi: Ndjesë, një nga palët deklaroi se “ne kemi seli atje, po nuk kemi zyrë zgjedhore...”.

Z. I. Rusmali: Jo mos me ik në pyetje tjetër, nëse e more fjalën për të më dhënë përgjigje për pyetjen time

Znj. J. Josifi: Me fal, por dua të lidh zyrën me subjektet zgjedhore.

Z. I. Rusmali: Dakord, doni të hapni një temë tjetër, mos më largo nga pyetja ime, të lutem!

Znj. J. Josifi: Jo, ndjesë! Ju thatë “pse zyrat zgjedhore ja atribuoni partisë dhe jo kandidatit”?

Z. I. Rusmali: Dakord!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 16, 19.01.2024*

Znj. J. Josifi: Dakord! Atëherë, Udhëzimi i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 6, dt. 23 mars 2021 “Për përdorimin e materialeve propagandistike dhe edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore” në nenin 2 “përkufizime” thotë “Zyra zgjedhore janë mjediset/zyrat që përdoren nga subjektet zgjedhore, apo kandidatët e tyre për qëllime të fushatës zgjedhore”. Pra, ose subjekti, ose kandidati...

Z. I. Rusmali: Po kjo nuk do të thotë që ju jeni të lirë t’ia ngarkoni kujt tu dojë qejfi. Do t’ia ngarkoni atij që në fakt ka pas financimin e fushatës, apo jo?!

Znj. J. Josifi: Po, është e vërtetë. Në rastin.., në se do të shihni kërkesën e Komisionerit, në rastin psh të subjektit zgjedhor Partia Demokratike, nuk është dorëzuar asnjë raport kandidati...


Z. I. Rusmali: Kjo është çështje tjetër!

Znj. J. Josifi: Nuk kishim ku ta verifikonim këtë gjë, nëse zyra i takonte kandidatit, apo subjektit. Ndodhur në kushtet që raportet e kandidatit nuk u vunë në dispozicion, do të thotë që zyrat ua faturuam...

Z. I. Rusmali: Kjo është çështje tjetër. Ju jeni para kazuat që një subjekt çfarëdo qoftë ai nuk refuzon të deklarojë.

Znj. J. Josifi: Po!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt. 16, 19.01.2024

Z. I. Rusmali: Dhe ju do ngarkoni me përgjegjësi, me faj subjektin. Në rastin konkret ju keni dy alternativa, o njërin, o tjetrin. Pyetja ime është, pse keni zgjedhur njërin dhe jo tjetrin? Kjo është pyetja! Është hetuar që është ky subjekti përgjegjës dhe nuk është ky tjetri? Dakord! Ta marr nga këndvështrimi i zotit Sefa. Zoti Sefa tha “kandidatët, të gjitha shpenzimet për fushatën zgjedhore të 6 marsit, i takojnë subjektit politik, nuk i takojnë kandidatëve. Kandidatët kanë zero lekë shpenzime për të gjitha dhe për rrjetin social janë marrë nga arka e partisë..” e tha sot. Pretendimi i palës, si ja hidhni poshtë ju këtë pretendim palës?! Që është partia dhe jo kandidati!

Znj. J. Josifi: Nëse ka ndodhur kështu do të duhej të ishte dokumentuar me transaksion bankar. Pra, pala duhet të provojë që partia përkatëse i ka kaluar në llogarinë bankare kandidatit për t’i mbuluar shpenzimet...

Z. I. Rusmali: Jo si ka... partia ka paguar facebook-un direkt, është lidhur me facebook-un dhe ka bërë pagesën te facebook-u për kandidatin. Tani ky është pretendimi dhe partia thotë “unë dhe e kam deklaruar këtë si shpenzim timin”. Kjo është çështja e dytë. Ju çfarë keni verifikuar nga këto?

Znj. J. Josifi: Për sa i takon verifikimeve në rrjetet sociale, informacioni që ne verifikojmë është publik. Mund ta verifikojë kushdo sot, sepse facebook-u të mundëson që për të gjitha llogaritë të cilat janë llogari subjektsh, pra të regjistruara, për ilustrim me atë “tikun” jeshil nëse e keni parasysht, për llogarinë, këtu i referohem “account” në emër, mbiemër të personit i cili është i brand-uar si llogari në facebook-u, mundet që me kufizimet kohore të periudhës së monitorimit të fushatës zgjedhore të shohësh, sa postime ka bërë kjo llogari. Në krah, po facebook-u vetë jep edhe

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 16, 19.01.2024*

çmimin e një postimi. Pra, ajo që ne kemi bërë në këtë rast është një shumëzim i thjeshtë në një informacion publik, lehtësisht të verifikueshëm për të gjithë.

Z. I. Rusmali: Po, por nuk keni verifikuar se kush ka bërë pagesat?!

Z. Y. Merkaj: Ideja është që të gjitha transaksionet, pagesat duhet të bëhen on-line dhe të jenë transparente, qoftë dhe subjekti kur do të financojë kandidatin, duhet ta deklarojë kandidati te shpenzimet e tij. Këtë pagesë për postimin në facebook e kam marrë nga subjekti zgjedhor, partia ime që më ka kaluar në këtë llogari bankare...

Z. I. Rusmali: Këtë detajim e keni bërë ju?

Z. Y. Merkaj: Se ka ai, nuk e ka sjellë...

Z. I. Rusmali: Ju a e keni bërë, ai se ka! E ka fshehur! Ju kur keni bërë procedurat tuaja administrative dhe e keni konstatuar këtë shifër, e keni ndjekur shifrën deri në origjinë, apo jo?!

Z. Y. Merkaj: Po e kemi ndjekur, se ne kemi parë deklaratimet që ka bërë kandidati...

Z. I. Rusmali: Dakord, si e rrëzoni deklarinimin e avokatit të partisë që thotë “nuk janë shpenzime të kandidatit, janë shpenzime të partisë”. I ka bërë shpenzimet partia, jo kandidati. Si e rrëzoni?

Z. Y. Merkaj: Duhet ta deklarojë, o partia, o kandidati.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 16, 19.01.2024*

Z. I. Rusmali: Po lëre kush do ta deklarojë! Është shumë e thjeshtë. E keni kapur me presh në duar njeriun!

Z. Y. Merkaj: Po!

Z. I. Rusmali: Tani ju thoni që e keni bërë hetimin deri në origjinë të gjësë.

Z. Y. Merkaj: Po!

Z. I. Rusmali: Në origjinë të gjësë del kush ka paguar lekët. Ai sot thotë “unë kam qenë kandidat, por si kam paguar unë lekët. Lekët i ka paguar partia ime”. Ju si e rrëzoni këtë që ai thotë?!

Z. Y. Merkaj: Kemi lënë një detyrim që kandidati duhet të deklarojë çdo dhurim që merr...


Z. I. Rusmali: Është tjetër ajo. Si e rrëzoni faktin që s’ka qenë partia që e ka bërë?

Z. Y. Merkaj: Si ka deklaruar partia, si ka deklaruar kandidati, ai në facebook del që i ka hedhur...

Z. I. Rusmali: A e keni bërë hetimin deri në origjinë?

Z. Y. Merkaj: Po!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt. 16, 19.01.2024

Z. I. Rusmali: Në origjinë çfarë ju doli? Shifrën e kandidatit Sefa, kush e ka paguar? Çfarë ju doli?

Z. Y. Merkaj: Nuk ka rëndësi se kush i pagoi, për ne. Ne kemi parë që kandidati nuk ka qenë transparent dhe nuk ka deklaruar të gjitha shpenzimet.

Z. I. Rusmali: Po pse nuk bëni hetimin e gjërave, deri në fund!


Z. Y. Merkaj: Po duhet të kemi një prokurori të përgjithshme, nja 300 vetë...

Z. I. Rusmali: Dhe pastaj e keni të lehtë të thoni “refuzim për deklaram”...

Z. Y. Merkaj: Jo nuk është refuzim, nuk është transparent kemi thënë.

Z. I. Rusmali: Ylli dhe një gjë tjetër! Përmendën kolegët, por ndoshta duhet ta thellojmë pak më shumë. Udhëzimi juaj nr. 6 përcakton përcakton rregullat ku dhe si do të vendosen këto materialet vizive, statike çfarë quhen ato?! Ku dhe si vendosen? Thuhet që “vendosen në, pranë, ose jo më larg se kaq nga zyra elektorale e subjektit”. Ju keni zbatuar, siç e kuptoj unë në gjetjen e zyrave elektorale, këtë rregull e keni zbatuar në të kundërtën e vet. Pra, keni gjetur afishen dhe nga afishja keni kapur zyrën, në veprimin e kundërt. Ai kur vendos afishen, mat 150 metra jo më larg se zyra, apo sa është ajo se nuk e mbaj mend mirë. Ju keni shkuar në të kundërtën dhe keni thënë që “kjo është zyra elektorale”, apo jo? Monitoruesit tuaj e kanë bërë këtë gjë, e kanë provuar, e kanë dokumentuar me foto, krejt në rregull. Tani ngrihet një pretendim që thotë “billboard-i s’ka qenë në mjedis publik, s’ka qenë anash rrugës, s’ka qenë në fasadat e ndërtesave publike, etj., etj., ka qenë i

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 16, 19.01.2024*

vendosur në oborrin e brendshëm të një biznesi privat”. Kjo është besoj unë e dukshme qartë nga fotot, apo jo?! pse kjo çon në konkluzionin se jemi para një zyre elektorale? Pra, biznesi privat është zyrë elektorale në favor të subjektit dhe jo në konkluzionin se biznesi privat i ka bërë një donacion subjektit, të cilin subjekti e ka fshehur. Pse nuk është donacion, por është zyrë elektorale?

Z. Y. Merhaj: Problemi është që ky donacion duhet të deklarohet te llogaria e kandidatit...

Z. I. Rusmali: Dakord, po pse nuk është donacion, se mund të ishte fare mirë...

Z. Y. Merhaj: Po mund të jetë donacion, ta deklarojë që e ka donacion, por nuk e ka deklaruar.


Z. I. Rusmali: Në qoftë se është donacion ndiqet ndryshe, apo me të njejtën dispozitë?

Z. Y. Merhaj: Në qoftë se është donacion do të shihet. Nëse është brenda rregullave nuk ka për t’u ashtu... por ai e ka fshehur.

Z. I. Rusmali: Të lutem, në qoftë se është donacion i fshehur, ndiqet me dispozitën që ka refuzuar të bëjë deklarinimin, apo ndiqet me ndonjë dispozitë tjetër?

Z. Y. Merhaj: Ndoshta dhe me ndonjë dispozitë tjetër, nuk mund t’ju jap dot përgjigje në këto momente, por që është shkelje, po.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 16, 19.01.2024*

Z. E. Çefa: Zoti Sefa, po!

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD: Kam pyetje për Sekretarin e Përgjithshëm. Selitë e degëve dhe selitë e partisë, ju i konsideroni zyra elektorale në të gjitha rastet?

Z. Y. Merkaj: Në qoftë se e përdor sipas udhëzimit nr. 6, dt. 23 mars 2021 të KSHZ, quhet zyrë zgjedhore “mjediset, ambjentet që përdoren nga subjektet zgjedhore, apo kandidatët e tyre për qëllime të fushatës zgjedhore”.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD: Po një zyrë që përdoret gjatë gjithë vitit?

Z. Y. Merkaj: Ne po flasim për periudhë zgjedhore, për katër muaj para zgjedhjeve.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD: Ju më këni dhënë një praktikë mua që jam unë këtu, keni hyrë dhe brenda...


Z. Y. Merkaj: Po, që po bën fushatë për kryetar të Bashkisë Lushnje.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD: Brenda është fotografia e selisë së Partisë Demokratike, thotë “Partia Demokratike, dega Lushnje”, është në fotografi. Tani kjo është zyrë elektorale, apo selia e Partisë Demokratike?

Z. Y. Merkaj: Zotëri, ti ke marrë pjesë në zgjedhje, duhet ta deklaroje zyrën, nuk e ke deklaruar, kaq, është shumë e thjeshtë gjëja.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD: Unë e kam deklaruar...

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 16, 19.01.2024*

Z. Y. Merkaj: Nuk e ke deklaruar, je në shkelje të Kodit Zgjedhor.

Z. L. Braho: Kam unë një pyetje. Pse duhet të besojmë monitoruesin dhe të mos besojmë partinë politike? Ai një njeri është...

Z. Y. Merkaj: Monitoruesi ka marrë një detyrë, ka bërë një betim, ka nënshkruar një kontratë...

Z. L. Braho: Po partitë politike janë kushtetuese.

Z. Y. Merkaj: Gjithë periudhën e monitorimit e ka sjellë me prova ai dhe jashtë dhe brenda. Ka bërë foton jashtë, ka hyrë brenda dhe ka parë që është zyrë që përdoret për qëllime elektorale. Partia se ka deklaruar. Ky është problemi, pse se ka deklaruar? Për këtë kemi propozuar masën.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD: Këtë zyrë Partisë Demokratike ja ka dhënë Këshilli i Bashkisë Lushnje në vitin 2011, me vendimin nr. 4, a 5, nuk e di, në mos gabo. Tani, unë si ta deklaroj këtë me çfarë vlere? Duhet ta deklaroj me një vlerë, apo jo? Përveç kësaj, pyetje tjetër. Kryetari grup-seksioni nr. 5 ka ambjentin e tij dhe thotë “te ky dyqani im, mbushe me postera”...

Z. I. Rusmali: Tani, të mos nisemi nga kazuse për të shkuar te analiza ligjore e gjëse. Analiza ligjore e gjëse është e qartë, si analizë ligjore...

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD: Nuk është bërë arësyetimi në konceptin tim, e para.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 16, 19.01.2024*

Z. I. Rusmali: Dakord, kryetari i grup-seksionit nuk e mbush dot se udhëzimi nr. 6 nuk e lejon fare të vendosë postera te dyqani vet. Pyetja që bëhet në këtë rast është: a ka marrë masa KQZ-ja me autoritetet lokale që këto billboard-et që nuk janë sipas udhëzimit nr. 6 t'i heqë? I keni marrë masat më 6 mars të 2022?

Z. Y. Merkaç: Po, të gjithë kryetarët e bashkive, të gjashtë, ose më pak kanë sjellë në KQZ vendet për afishimin e materialeve propagandistike. Ata kryetarë bashkie që nuk i kanë sjellë janë gjobitur nga Komisioneri.

Z. I. Rusmali: Nuk po flas për kryetarët e bashkive, pse i ikni gjithmonë pyetjes? Janë hequr? Ose janë zyra elektorale dhe nuk i heq dot posterat, ose nuk janë zyra elektorale siç thotë ai dhe posterat hiqen. Është o njëra, o tjetra. Tani, ky veprim ka ndodhur në ato zgjedhje, janë hequr atje ku nuk u takon, ato 33 raste ju i keni konsideruar zyra elektorale dhe nuk jeni qasur për t'i hequr?

Z. Y. Merkaç: I kemi quajtur zyra elektorale, pse duhet t'i hiqim? Ato funksiononin si zyra elektorale, nuk kishte vetëm materiale propagandistike. Ato funksiononin si zyra elektorale.

Z. E. Çefa: Zoti Sefa, diçka tjetër të rëndësishme për procesin, besoj se tani dolën.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD: Jo nuk kam gjë të rëndësishme!

Z. I. Rusmali: Një pyetje për Yllin. Zoti Sefa tha “për rrethana specifike të periudhës” dhe besoj se ne e mbajmë mend periudhën, subjekti e ka pas të pamundur

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 16, 19.01.2024*

të dorëzonte në kohë raportimin. Ky justifikim, se rrethanat specifike, besoj dihen. Ky justifikim pse është i papranueshëm për ju?

Z. Y. Merkaj: Atëherë, afati i parashikuar me ligj është 60 ditë nga shpallja e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve. Afati që ka caktuar Kodi Zgjedhor është i mjaftueshëm për ta përpiluar subjekti zgjedhor që ka marrë pjesë në zgjedhje, ta përpilojë dhe ta sjellë në afatin e përcaktuar nga neni përkatës. Megjithatë mendoj se nuk ka pasur ndonjë arsye, ose justifikim nga PD-ja që “unë do ta sjell jashtë afatit për këto arsye”. Nuk na ka dhënë arsye. Thjesht nuk është përgjigjur, nuk ka bashkëpunuar.

Z. E. Çefa: Po zoti Sefa!

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD: Një pyetje për Sekretarin e Përgjithshëm.

Z. E. Çefa: Për këtë?


Z. I. Sefa, përfaqësues i PD: Po, po për këtë?

Z. I. Rusmali: Në anën tëndë të gjësë?

Z. K. Bele: O zotëri na i lër ne pyetjet.

Z. I. Rusmali: Zoti Sefa ju keni pas hall në atë periudhë. Jo të lutem prit, dëgjo pyetjen ju lutem! Ju keni pas hall në atë periudhë dhe e keni pasur të pamundur të prodhoni dokument se disa dokumenta ju ishin zhdukur, kështu thatë ju më parë.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 16, 19.01.2024*

Por mundësinë për të komunikuar me zotin Merkaj e keni pasur. Mund t'i kishit thënë ne kështu e kemi hallin do vonohemi ca. Këtë gjë e keni bërë?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD: Po i nderuar, shumë komunikime me Partinë Demokratike janë zhvilluar në adresën zyrtare që ka qenë Bulevardi Zhan D'ark nr.11., të cilat ne nuk i administronim si persona përgjegjës që duhet të kishim kontakte në KQZ si sekretar...

Z. I. Rusmali: Telefoni, e-mail?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD: Kur jemi kontaktuar me telefon, shumë më pas, dokumentat e KQZ-së janë dërguar në grupin parlamentar të Partisë Demokratike në atë kohë.

Z. I. Rusmali: Dakord, por ju vetë me nismën tuaj ja keni qarë hallin KQZ-së që po shkelnit afatin, apo ju kishte dalë nga vëmendja për shkak të emocioneve të situatës?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD: E vërteta është që kishim mangësitë tona edhe për gjetjen e dokumentave, e dyta është që ne e kemi paraqitur raportin. Me vonesë..

Z. I. Rusmali: Sa vonë?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD: Nuk e di...

Z. I. Rusmali: Sa vonë zoti Merkaj?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 16, 19.01.2024*

Z. Y. Merkaj: Nuk mund ta them për momentin.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD: Ja ta gjej unë. Ne e kemi paraqitur në 23.06.2022, kur afati i fundit ka qenë.., mund të jetë 20 ditë me vonesë diçka e tillë, se duhet parë rezultati përfundimtar, kur mbyllet rezultati zgjedhor i 6 marsit, mund të jetë mbyllur në fund të marsit, besoj...

Z. I. Rusmali: Është e vërtetë që ka ardhur 20 ditë me vonesë Zoti Merkaj?

Z. Y. Merkaj: Nëse kanë qenë zgjedhjet për 6 bashki dhe rezultati përfundimtar i zgjedhjeve ka dalë me shpejt.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD: Raporti juaj thotë “Në kuadër të shkresës datë 01.06.2022, bashkëlidhur gjeni dokumentacionin e kërkuar”. Pra, ne në datën 1 qershor na është kërkuar raporti dhe brenda 23 ditëve kemi dërguar raportin. Kam dhe diçka tjetër, po të shihni dhe në përmbledhjen që ka bërë KQZ-ja të nderuar, Partia Demokratike është partia që ka shpenzuar më shumë për fushatën zgjedhore. E kemi deklaruar! Nuk ka qenë qëllimi që nuk kemi dashur të deklarojmë dhe s’kemi sjellë as raport. Ajo dispozitë është kur ti nuk bën deklarin, nuk sjell raport dhe nuk i jep llogari KQZ-së për gjithë veprimtarinë tënde politike dhe financiare. Në këtë koncept, nuk është kjo dispozitë që zbatohet në këto raste dhe unë nuk e kuptoj pse paqartësitë në deklarin përputhen me refuzimin për të deklaruar. Ju siç e shikoni, ne kemi një deklarin të detajuar dhe kontratën dhe faturën e të gjitha me rradhë, me të gjitha subjektet...

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 16, 19.01.2024*

Z. Y. Merkaç: Ka dy momente këtu, KQZ në bazë të nenit 92/6 i ka dërguar kërkesë Partisë Demokratike. Partia Demokratike nuk i është përgjigjur kërkesës tonë. Edhe në rastin siç pretendon përfaqësuesi që ka ndryshuar selinë ose vendndodhjen është i detyruar përfaqësuesi i partisë në KQZ, të deklarojë vendndodhjen e selisë së partisë. Këto dy raste nuk kanë ndodhur, dhe tjetra, 92/6 thotë që “raportojnë në prokurori si vepër penale”. Ne këtë nuk e kemi bërë duke parë këto problematika, kemi bërë vetëm masën administrative.

Z. E. Çefa: Po, zonja!

Znj. J. Josifi: Sa i takon argumentit të palës që kërkesën që ka marrë nga KQZ-ja për të paraqitur raportin financiar, ata nuk kanë mundur ta marrin kurrë në adresën ose vendodhjen që ata kishin akses apo jo, kjo nuk qëndron. E para, se neni 92/3 i Kodit Zgjedhor thotë se “subjektet zgjedhore janë të detyruara të paraqesin raport financiar për fushatën zgjedhore në KQZ brenda 60 ditëve nga shpallja e rezultatit të zgjedhjeve”. Pika 2 sqaron se si hartohen raportet financiare sipar modeleve të miratuara nga KQZ. Ndërkohë detyrimi për të raportuar i kandidatëve të listave shumemërore dhe kandidatëve për kryetarë bashkie në këtë rast është i sanksionuar në vendimin 9, datë 29 janar 2022, të Komisionit Rregullator. Neni 9, pika 2 thotë: “kandidatët e listave shumemërore dhe kandidatët për kryetarë bashkie..” që është ky rasti, “.. kanë detyrim të dorëzojnë të financieri..”, i referohet financierit të subjektit zgjedhor, “.. brenda 30 ditësh nga data e zgjedhjeve, dokumentacionin për fondet e fituara dhe shpenzimet e kryera prej tij gjatë fushatës zgjedhore. Financieri përgjigjet për dokumentacionin e dorëzuar nga kandidati e listave shumemërore dhe kandidatit për kryetar bashkie, me përjashtim të rastit kur nga hetimi administrativ vërtetohet që nuk ka pasur mundësi, ose me gjithë përpjekjet e bëra nuk ka arritur të

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 16, 19.01.2024*

ndalojë ose korigjojë shkeljen e kryer nga kandidati”. Vendimi nr. 9, datë 29 janar 2022, i Komisionit Rregullator. Kjo do të thotë që 30 ditë nga data e zgjedhjeve kandidatët për kryetarë bashkie duhet të kishin depozituar gjithë sa thamë, te subjekti zgjedhor për të cilin kandidonin dhe subjekti zgjedhor ndërkohë kishte kohë 60 ditë nga shpallja rezultetit përfundimtar, për të bërë gjithë raportimin financiar të nevojshëm. Në rastin e këtij subjekti zgjedhor nuk ka pasur asnjë raport financiar të kandidatëve për kryetarë bashkie të dorëzuar. Kjo do të thotë që, nuk është respektuar as formati i raportimit financiar të subjektit zgjedhor, i cili duhet të kishte pjesë integrale raportet e kandidatëve përkatës. Nuk është çështja këtu morëm kërkesë nuk morëm kërkesë. Nuk merret kërkesë! Njëse do më lejoni përsa i përket zyrave zgjedhore të cilat nuk janë raportuar mund t’ju ilustruojmë. Të gjitha raportet e monitoruesve janë publike ne faqen e KQZ-së. Psh, rastin e Bashkisë Durrës, të zyrave zgjedhore me foto brenda jashtë dhe lokacion ne hartë? Është vetëm një moment, nëse ju më lejoni. Faleminderit!


(Bëhen disa ilustrime të raporteve të monitoruesve në seancë, nga zonja Jona Josifi).

Znj. J. Josifi: Raportet e monitoruesve janë çdo 10 ditë gjatë 4 muajve. Monitoruesit duhet të dorëzojnë një raport, ky raport quhet i ndërmjetëm. Krahas këtij raporti monitoruesi mund të dorëzojë raport dhe çdo ditë. Konstatova sot diçka e dërgon raportin sot. Çdo monitorues në fund dorëzon një raport përfundimtar.

(Shfaqen disa foto dhe komentohen)

Znj. J. Josifi: A është zyrë zgjedhore kjo?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 16, 19.01.2024*

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD: Zyrë partie, po!

Znj. J. Josifi: A është zyrë zgjedhore e përdorur për qëllime të kësaj fushate. Posi jo, kur ishte kandidat ky zotëria? S'ka qenë ky?

Z. E. Çefa: Ju lutem mos debatoni! Zoti Sefa mos bëni debat ju lutem!

Znj. J. Josifi: A është zyre zgjedhore? A janë mbledhur simpatizantët? Ku janë mbledhur?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD: Po nuk është kandidat, ngreje pak më lart atë, çfarë flamuri është ai?

Znj. J. Josifi: I PD-së.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD: I PD-së dhe i Shqipërisë, apo jo?


Znj. J. Josifi: A është përdorur për qëllimet e fushatës zgjedhore?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD: Partia? Po partia për...

Z. E. Çefa: Ju lutem, jo debat zoti Sefa, i bëtë parashtrimet ju, jemi në tjetër moment tani!

Znj. J. Josifi: Ja ku kemi një zyrë tjetër! Njësia administrative, Qerret Katund i Ri!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 16, 19.01.2024*

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD: Po! Tani kjo është zyrë elektorale thoni ju?

Znj. J. Josifi: Tani edhe ky?! Ky është kryetar partie?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD: Kjo është zyrë elektorale thoni ju?

Znj. J. Josifi: Zotëri, thotë Luan Hoti, kandidat për kryetar bashkie...

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD: Po!

Znj. J. Josifi: Doni të hapim një raport tjetër tani? Sa zyra zgjedhore janë në Durrës të padeklaruara?!


Z. E. Lako: Ylli, ne këtë kërkojmë përveç fotove, çfarë hetimi ka bërë KQZ-ja që tregon, që provohet koorespodenca me forcën politike për përdorimin e këtyre zyrave, që këto zyra kanë qenë ashtu siç pretendohet zyra zgjedhore, apo seli të partisë? Apo që janë përdorur përkohësisht për të vendosur ndonjë banderolë nga ndonjë subjekt privat? Këtë hetim po kërkojme ne! Dmth hetimi është mjaftuar vetëm te raportimi i monitoruesit, te fotoja dhe kaq?

Z. Y. Merkaç: Po, edhe te fotot!

Z. E. Lako: Dakord pra, ne po themi çfarë hetimi keni bërë ju veç raportit të monitoruesit?

Z. Y. Merkaç: Bashkia Durrës ka 13 zyra të tilla...

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 16, 19.01.2024*

Z. E. Lako: Keni bërë ju ndonjë krahasim psh selia e partisë dega Lushnje, kë ka të regjistruar në gjykatë ai zotëria?

Z. Y. Merkaç: Po ç'rëndësi ka kjo?

Z. E. Lako: Kë ka raportuar si zyrë zgjedhore?

Z. Y. Merkaç: 13 zyra ka Durrësi. Dakord 1 është seli e partisë. Po 12 të tjerat ku janë?

Z. E. Lako: Pra, jeni mjaftuar thjesht te raporti i monitoruesit? Nuk keni bërë hetim të mëtejshëm për të parë..?

Z. Y. Merkaç: Ai ka thënë, "kjo është zyrë zgjedhore", është futur brenda, kemi parë që është zyrë, kaq.

Z. E. Çefa: Ne ju falenderojmë, besoj se ne e kapëm konceptin. Zoti Sefa, ju ftoj të zini vendin tuaj. Besoj e ezauruam totalisht pikën e parë të kërkesës së Komisionerit. Kështu unë mendoj t'i jap fjalën duke kërkuar edhe ndjesë përfaqësuesve të... Zoti Legisi, diçka tjetër? Në konkluzionet përfundimare do të keni sërish rastin për t'u shprehur gjithsesi.

Z. M. Legisi, përfaqësues i PS: Dakord, në konkluzionet përfundimtare do të shprehem edhe për ndonjë shtesë. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 16, 19.01.2024*

Z. E. Çefa: Dakord! Atëherë, u jap fjalën duke filluar nga zoti Nuri, për çështjet e kandidatëve.

Z. F. Nuri, avokat për z. Ardian Muka: Faleminderit zoti relator. Unë jam këtu me prokurë të posaçme, e depozituam, në lidhje me rastin e kandidatit të Shtëpisë së Lirisë zotit Ardian Muka, në zgjedhjet e 6 marsit 2022. Për shkak se kemi marrë dijeni, kandidati ka marrë dijeni nga ana juaj se është sanksionuar me një gjobë në vlerën rreth 450 000 lekë të reja mos gaboj. Atëherë kandidati në pamundësi për të qenë vetë prezent sot, për shkak të një angazhimi jashtë shtetit ka dashur që të shprehë qëndrimin e tij me shkrim. E ka depozituar vetë personalisht. Ka të gjitha argumentat e veta të faktit dhe ligjor sipas tij. Së bashku me argumentat e kandidatit, unë desha të paraqes edhe provat, po i depozitoj njëkohësisht. Këtu kemi një steatment të Intesa San Paolo Bank, ku ka pasur dhe llogarinë specifike, llogarinë e posaçme, kandidati i përzgjedhur dhe ku janë kryer dhe lëvizjet subjekt të kësaj procedure, lëvizjet financiare. Gjithashtu kemi dhe tre fatura tatimore që dëshirojmë t'ia vendosim në dispozicion edhe KAS-it, me të cilat kandidati justifikon shpenzimet që nuk janë aspak dhurim ndaj vetes. Nuk janë aspak dhurim se nuk kanë se si të jenë, por janë para të tërhequra nga llogaria speciale me iniciativë të kandidatit për shkak që dhe e ka shpjeguar. Besoj se figuron te materiali i bankës, te historiku për shpenzime për fushatën. Por, shpenzime të cilat ai ishte i detyruar t'i kryente në *cash*. Pse ishte i detyruar t'i kryente në *cash* ato shpenzime? Ja ku kemi dhe faturat që koorespondojnë me ato shpenzimet përkatëse, sepse siç e shpjegon dhe vetë kandidati në materialin me shkrim që po depozitojmë, kompanitë apo subjektet private ja kanë kërkuar në këtë formë. Nuk kanë dashur që të paguhen me bankë. Duke qene se pagesat janë brenda limitit 150 000 leke të reja, që ligji e lejon që mund të paguhen dhe *cash* kandidati ka zgjedhur këtë formë në kushtet kur ishte dhe

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 16, 19.01.2024*

fushata, që ishte dhe një periudhë e shkurtër kohore. Pra, më lejoni t'ju vë në dispozicion këto materiale fillimisht, mund t'i shihni dhe vetë nga afër.

Z. E. Çefa: Dikush nga administrata të administrojë provat. Shkurtimisht besoj se do na vlente të na i citonit pak edhe shpjegimet e kandidatit!

Z. F. Nuri, avokat për z. Ardian Muka: Po kemi dhe materialet. Po patjetër! Kemi këtu dhe këto materialet që kanë lidhje me shpezimet e facebook-ut. Edhe këto, janë edhe këto te treja mbrapa. Kandidati ka qenë mjaft skrupuloz. Unë po ju jap disa shpjegime. Fillimisht, ne shohim që ankimimi është bërë nga ana e KRIIK-ut, organizata KRIIK, sepse ka konstatuar në lidhje me zotën Muka, se ka pranuar dhurim me vlerën mbi 50 000 lekë të reja dhe sqarimi është që i ka dhuruar vetes. Nuk e di se si dikush mund t'i dhurojë vetes, kjo mund të jetë një çështje tjetër. Kandidati i paska dhuruar vetes pikërisht shumën 415 000 lekë të reja *cash* të ndara këto në tre këste, që faktikisht ato janë tre fatura kooresponduese që kemi venë në dispozicion, pra fatura që ai ka paguar.

Z. K. Bele: I ka deklaruar si donacione ai, më fal?


Z. F. Nuri, avokat për z. Ardian Muka: Jo në dijeninë time jo. Ndoshta mund ta ndërpresim këtu dhe të presim shpjegimin e KQZ-së. Gjithsesi, unë po relatoj ndërkohë dhe argumentat e kandidatit, i cili pretendon që i ka respektuar të gjitha kriteret dhe kushtet ligjore të përcaktuara. Më konkretisht ka depozituar vlerën totale prej 950 000 lekë të reja në mos gabo, në llogarinë speciale në disa derdhje dhe prej tyre ka tërhequr 415 000 lekë, që koorespondon me shumën e gjobës me motivacionin se kandidati i ka ndarë në tre këste, sepse i ka paguar subjekteve

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 16, 19.01.2024*

private. Pra, edhe një herë, në cilësinë e kandidatit ai deklaroi se ka derdhur në llogari speciale gjithsej 950 000 lekë të reja, nga limiti prej 1 milion lekë të reja. 10 milion lekë të vjetra që lejohej. Fillimisht për shumën 900 000 lekë të reja në 1 mars 2022, pastaj 7 000 lekë të reja dhe më pas 42 000 lekë të reja, më 11 maj 2022. Ka pranuar nga disa furnitorë shërbimesh gjatë fushatës zgjedhore që nuk kishin llogari bankare pranë bankës ku ai kishte llogarinë speciale. Pra, ka pranuar shërbimet e tyre në respekt të ligjeve për veprime financiare në Republikën e Shqipërisë, ku lejohet pagesa *cash* deri në vlerën 150 000 lekë. Kandidati deklaroi se ka kryer tërheqje nga llogaria speciale për të mbuluar pikërisht këto tre pagesa dhe specifikoi se këto janë kryer më datë 16 mars 2022, ku ka paguar vlerën 120 000 lekë me faturën 01.03.2022. Ka tërhequr shumën 150 000 lekë për të paguar faturën e datës 04.03.2022 dhe vlerën 145 000 lekë, për pagesën me faturë të datës 10 mars 2022. Pjesën e mbetur, thotë kandidati, që ka tërhequr në një llogari të tij personale, e ka lidhur me kartën e kreditit dhe debitit për pagesën e shpenzimeve të facebook-ut, për sponsorizimin e faqes së tij gjatë fushatës në shumën total 886.45 dollarë amerikanë. Këto fatura janë paguar nga karta personale, sqaron kandidati se facebook nuk pranonte asnjë mënyrë tjetër pagese, përveç kartë krediti në emër të personit që e kryente, që bënte sponsorizimin. Për të gjitha informacionet e mësipërme i ka detajuar dhe në vijim, kandidati pretendon se ka kryer jo vetëm që nuk ka kryer shkelje ligjore, por ka tentuar të jetë sa më rigoriz. Aty keni disa faqe që mund të ketë bërë dhe pagesat për facebook-un që nga vlera 2 dollarë, 10 dollarë, 20 dollarë etj. Sipas shpjegimeve që pata mundësinë të marr nga kandidati, tre faturat ndoshta nuk kanë pasur dijani. Këto fatura ndoshta depozitohen për herë të parë. Kjo është dhe arsyeja pse ndoshta KRIIK-u ka ngitur këto shqetësime, sepse ai faktikisht i ka pasur këto fatura të shpenzimeve të vërtetuara. Prandaj ne e shohim si absurd përdorimin e termit “dhurim ndaj vetes”.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 16, 19.01.2024*

Z. E. Çefa: Unë vijoj të jem i paqartë, nëse e kemi kuptuar të gjithë, atë që ka kërkuar, apo çfarë ka ngrit Komisioneri. Siç e shoh unë këtu akuza, nuk është se ka shpenzuar më shumë se limiti?

Z. F. Nuri, avokat për z. Ardian Muka: Jo!

Z. E. Çefa: Komisioneri pretendon që kandidati për kryetar bashkie që ju përfaqësoni, ka arkëtuar mbi limitin e parashikuar në ligj. Pra, ka arkëtuar në *cash*, jo ka shpenzuar. Pra, veprim i anasjelltë.

Z. F. Nuri, avokat për z. Ardian Muka: Kështu i bie, sepse akuza është...

Z. E. Çefa: Sepse ju deri tani argumentuat për shpenzimet, ndërkohë duhet të na argumentoni veprimin e anasjelltë. Pra, për arkëtimet!

Z. F. Nuri, avokat për z. Ardian Muka: Unë mendoj se duke parë dhe materialin e ardhur ku thuhet se “zoti Ardian Muka në raportin e tij si kandidat i Koalicionit Shtëpia e Lirisë, i ka dhuruar vetes shumën 415 000 lekë *cash* (të ndara në tre kështe dhuruar në 120 mijë lekë, 150 mijë lekë dhe 145 mijë lekë)”. Pra, kjo është akuza e ngritur. Kjo shifër koorrespondon fiks me tre faturat që zotëria ka paguar *cash* dhe janë paguar *cash* pasi janë hequr fondet nga llogaria speciale. Pra, i ka futur fondet në llogari speciale për efekt të fushatës. Pastaj duke parë që furnitorë dhe shërbime të ndryshme nuk e pranoin pagesën me bankë, për një arsye apo për një tjetër, është detyruar t’i tërheqë përsëri ato dhe t’ia paguajë *cash* dhe kemi dhe faturat bashkëlidhur. Nuk ka asnjë lloj dhurimi këtu ndaj vetes. Ai thjesht i ka tërhequr për

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 16, 19.01.2024*

të bërë pagesa. E vërteton me anë të faturave përkatëse. Kjo ishte, besoj unë, e gjithë fabula.

Z. E. Çefa: Përpara se t'ju jap fjalën edhe kandidatëve të tjerë, zoti Merkaj na e sqaroni ju lutem edhe njëherë këtë konkluzionin tuaj, që vlen për të gjithë në fakt këtu, dmth që i kanë dhuruar vetes. Çfarë keni konstatuar konkretisht?

Z. Y. Merkaj: Është një model që ka miratuar KQZ-ja. Janë bërë trajnime të shumta me financierët e partive politike dhe me kandidatët. Janë trajnuar se si do të plotësohet ky formulari. Te formulari ka një rubrikë që thotë “fondet e dhuruara nga personat fizikë ose juridikë”. Te kjo tabela janë gjithë emrat që kanë dhuruar dhe fakti që ai ka dhuruar më shumë se 50 000 lekë vetes së tij, ku thotë “Ardian Muka dhuruar kaq lekë me këstin e parë, këstin e dytë, këstin e tretë”.

Z. I. Rusmali: Është deklaram i tij?

Z. Y. Merkaj: Po, i tij, por e ka kaluar shumën 50 000 lekë. Ka deklaruar dhe shuma të tjera, nën 50 000 lekë.

Z. Y. Merkaj: Mund të na i jepni me detaje. Janë tre raste. Sa i ka dhuruar vetes në rastin e parë, sa i ka dhuruar në rastin e dytë dhe sa në rastin e tretë?

Z. K. Bele: Ka paguar një faturë, po themi një drekë që bëjnë këta kandidatët, në vlerën siç është kjo vlera këtu 90 000, apo 100 000 lekë të reja...

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 16, 19.01.2024*

Z. Y. Merkaj: Kjo është te llogaria bankare. Kjo ka kaluar nga emri i tij te llogaria e posaçme. Sepse kandidati përpara se të fillojë fushata zgjedhore, përpara se të regjistrohet si kandidat, ai ka detyrim ligjor të hapë një llogari të posaçme. Ai mund të ketë shumë lekë në llogarinë tjetër, por kjo llogari e posaçme, të gjitha financimet për fushatën zgjedhore duhet të kalojnë nga kjo llogari. Këto lekë i ka kaluar nga emri i tij në llogarinë te kjo bankë, te kjo llogari bankare, por ka kaluar shumën 50 000 lekë.

Z. K. Bele: Unë kuptova këtë, që unë si qytetar atij kandidati nuk i jap dot më shumë se 50 000 lekë.

Z. Y. Merkaj: Po!

Z. K. Bele: Atëherë, ai vetë nga llogaria e tij nuk merr dot lekë t'i përdorë?

Z. Y. Merkaj: Jo!

Z. K. Bele: Me çfarë do ta bëjë fushatën?

Z. F. Nuri, avokat për z. Ardian Muka: Po me çfarë do ta mbushë fondin?

Z. Y. Merkaj: Neni 173, pika 5, thotë “pranimi i fondeve private me vlerë më të madhe se 50 000 lekë përmes formave të tjera të ndryshme nga kalimi në llogari bankare dënohet me gjobë të barabartë me shumën e dhuruar”.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 16, 19.01.2024*

Z. K. Bele: Neni 173, pika 5 “pranimi i fondeve private...”. Po mirë është për fondet që paguajnë të tretët, apo edhe kur ti i nxjerr nga lekët e tua dhe paguan?

Z. Y. Merkaj: Po edhe nga lekët e tij.

Z. K. Bele: Të tretët dhe vetja janë dy gjëra të ndryshme. I treti është i treti!

Z. Y. Merkaj: Ne i kemi konsideruar edhe personin që përdor këtë llogari bankare...

Z. K. Bele: Pra, ju thoni kur personi financon nga fondet e tij një shumë mbi 50 000 lekë. Pra, nëse unë e kuptova drejt Ylli, në këtë fushatë nuk janë ndarë fonde nga partitë politike, nga KQZ-ja?

Z. Y. Merkaj: Jo!

Z. K. Bele: Supozojmë personi nuk ka donatorë, por ka lekët e tij. Ju thoni ai nuk mund të marrë pjesë në zgjedhje, nuk mund të financojë fushatën e tij me lekët e tij? Ose duhet të gjej persona që t’i japin donacione deri në shumën 50 000 lekë ose ai nuk mund të marr pjesë në zgjedhje?

Z. Y. Merkaj: Po!

Z. K. Bele: Ky është kuptimi? Ose është shkelje ta paguash fushatën me lekët e tij? Kam përshtypjen se duhet parë kjo, duhet të ndalemi te ky moment, se ndoshta nuk është kështu, duhet të kemi ndonjë...Se të paktën me çfarë kuptojmë në të gjithë botën njerëzit e paguajnë vetë fushatën e tyre, ose marrin lekë nga të tretët. Ti ke

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 16, 19.01.2024*

qëllim.., ligji, të kufizosh financimet e të tretëve qofshin ato të ligjshme, apo të paligjshme ke vendosur një limit. Biznesmeni që përdor lekët e tij në fushatë, nuk e di, ndoshta unë jam i keqkuptuar.

Z. E. Çefa: A mund të na shpjegoni ju lutem, dinamikën në rastin e zotit Muka. Dinamikën dmth unë vijoj mos ta kem të qartë shumë dmth...

Z. Y. Merkaç: Zoti Muka ka kaluar nga llogaria e tij bankare, te llogaria e posaçme, ka kaluar nga emri i tij në tre shuma.

Z. E. Çefa: Po pra, dispozita kërkon të bëhet në *cash*, nëse bëhet në llogari bankare është në rregull apo jo?

Z. Y. Merkaç: Nëse bëhet në më pak se 50 000 lekë se ka pasur edhe dhurime të tjera.

Z. L. Braho: Më pak se 50 000 lekë bëhet *cash*?

Z. E. Çefa: Mbi 50 mijë lekë duhet të bëhet në llogari bankare. Ju thoni që i ka kaluar nga llogaria personale në llogarinë e deklaruar për efekt zgjedhjeve?

Z. Y. Merkaç: Po!

Z. E. Çefa: Ku është shkelja këtu?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 16, 19.01.2024*

Z. Y. Merkaç: Ne e kemi arsyetuar, e kemi gjykuar që nëse e kalon në llogarinë e posaçme bankare më shumë se 50 000 lekë është shkelje.

Z. F. Nuri, avokat për z. Ardian Muka: Por nuk është kështu. Se po të jetë kështu i bie që nuk e mbush dot llogarinë. Më fal, po limiti 10 milion të vjetra, 1 milion të reja dmth. Ka dhe ajo një limit. Ai prandaj ka futur 950 000 lekë.

Znj. J. Josifi: Në këtë rast në raportin financiar për fushatë zgjedhore të subjektit zgjedhor ka pasur dorëzime dhe të raporteve financiare të kandidatëve siç e parashikon vendimi i Komisionit Rregullator që thamë. Në raportin financiar të kandidatit Ardian Muka në datat specifikisht 03.01.2022 para në dorë *cash* 120 000, emri i dhuruesit Ardian Muka, emri i përfituesit Ardian Muka. Kjo do të thotë që zotëria është paraqitur në arkën e bankës “x” dhe ka bërë derdhjen në llogarinë e tij 120 000 lekë dhe pastaj dhe dy këste të tjera siç thuhet në kërkesën e Komisionerit. Ne nuk po diskutojmë që ai i ka fshehur këto fonde që pastaj i ka përdorur për fushatën. Diskutimi është burimi, prandaj përcaktohet jo më shumë se 50 000 lekë. Duhet të kishte bërë transfertë bankare nga llogaria e tij po supozojmë në BKT, në llogarinë e tij të posaçme të hapur për efekt të fushatës zgjedhore.

Z. E. Çefa: Si e kuptoj unë dispozitën, nuk është ekzaktësisht kështu. Unë e kuptoj që ti nuk mund të pranosh para në *cash* dhe ti shpenzosh, por nëse personi, se ato para materializohen në kartmonedhë, që kështu do, apo nuk do, kur i tërheq nga një bankë dhe i fut në një llogari tjetër, pavarësisht se ti i ke marr *cash*, i ke numëru te sporteli dhe i ke futur në llogari, kjo nuk quhet transaksion *cash*. Ai nëpërmjet llogarisë e ka bërë transaksionin. Ato para i ka tërhequr nga një llogari e vetja dhe i

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 16, 19.01.2024*

ka dorëzuar në sportel të bankës në llogarinë e deklaruar në KQZ, a është kështu? A ka ndodhur kështu?

Znj. J. Josifi: Ju lutem, neni 173, pika 5 thotë “pranimi i fondeve private me vlerë më të madhe se 50 000 lekë përmes formave të tjera, të ndryshme nga kalimi në llogarinë bankare, dënohet me gjobë..”.

Z. E. Çefa: Kalim në llogari bankare, nuk kufizohet vetëm nga banka në bankë, kalimi në llogari bankare bëhet edhe nga individ i fizikisht i depoziton në llogari bankare. Qëllimi i dispozitës ...

Znj. J. Josifi: Por nuk duhet ta kalonte, sepse është 50 mijë lekë.

Z. E. Çefa:... është për të mos lejuar përdorimin e lekut të zi, të pisët, jo në bankë.


Z. F. Nuri, avokat për z. Ardian Muka: Po dhe unë jam mjaft i qartë për situatën tani, në lidhje me çfarë u diskutua. Ai e paska deklaruar edhe te steatment bankar burimin aty të parave nga BKT se u citua pak më parë. Sipas citimit që u bë dhe më parë...

Z. I. Rusmali: Dokumenti bankar...

Z. F. Nuri, avokat për z. Ardian Muka: Po dokumenti bankar...

Z. K. Bele: Në bankën Intesa San Paolo...

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 16, 19.01.2024*

Z. F. Nuri, avokat për z. Ardian Muka: Kishte llogarinë speciale...

Z. K. Bele:...është deklaruar që këto lekë janë tërhequr nga llogaria e tij.

Z. F. Nuri, avokat për z. Ardian Muka: Edhe paratë që ka derdhur ka thënë janë tërhequr nga BKT. Unë kështu e kuptova! Megjithatë duhet të keni parasysh diçka. Fushata në 2022... kanë qenë zgjedhje të parakohshme ose të pjesshme po themi, ka qenë 15 ditë fushatë, apo jo zoti Sefa se keni qenë dhe vetë kandidat? Po ti kishte transferuar, të dalim në aspektin privat, e zemë se do t'i kishte transferuar me bankë, nga BKT te Intesa. E dini ju që do tre ditë pune që të kalojnë paratë nga një bankë te tjetra, kur nuk i ke brenda një banke? Çfarë ka bërë? I ka tërheq *cash* dhe i ka depozituar brenda. Ky ka qenë qëllimi. Pra, qëllimi nuk ka qenë të shmangim procedurat apo të shmangim burimin e të ardhurave.

Z. E. Çefa: Të dëgjojmë pak dhe përfaqësuesin e tjerë tani.

Z. F. Nuri, avokat për z. Ardian Muka: Unë kështu e kuptova, faleminderit!

Z. E. Çefa: U morëm shumë me këtë në mënyrë që të konkludojmë pastaj.


Z. E. Lufa, përfaqësues i znj. E. Sako: Faleminderti! Jam përfaqësues i zonjës Emirjana Sako dhe jam i sanksionuar pak a shumë po në këtë lloj koncepti, për tejkalimin e shumës mbi 500 000 lekë të parashikuara nga neni 173, pika 5 e Kodit Zgjedhor. Normalisht në gjykimin tim dhe në provat që unë do të paraqes, se kam bërë një prapësim shumë të shkurtër. Në gjykimin tim fillestar sipas udhëzimit 13 datë 14 shkurt 2022 të Komisionit Rregullator, pika 1 shprehet dhe thotë që "Burimet

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 16, 19.01.2024*

dhe financimet e fushatës zgjedhore për kandidatët janë..” ndër të tjera, “...financime nga burime vetjake të kandidatit...” pa përcaktuar limite. Kjo është e para e kësaj. E dyta, prapë në gjykimin tim sipas nenit 92/2 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë në pikën 4, përcaktohet një limit dhe thotë “shuma e shpenzimeve të bëra nga një subjekt zgjedhor përfshirë kandidatët e tij për një fushatë zgjedhore, nuk do të jetë më shumë se tre herë më e madhe se shumën më të lartë që ka marrë një subjekt zgjedhor nga fondet publike për qëllime zgjedhore, në përputhje me nenin 88, të këtij ligji”. Gjithashtu thotë: “çdo shpenzim i fushatës zgjedhore dokumentohet dhe zbatohet në përputhje me legjislacionin fiskal në fuqi”, flasim sërish për këtë nen. Gjithashtu në zbatim të ligjit “shpenzime fushate është çdo shpenzim që bën një parti, ose kandidat i saj për qëllim të fushatës zgjedhore pavarësisht nga data kur është bërë”. Tani Emirjana Sako, akuzohet për shumën 92 775 lekë që ka tejkaluar limitin. Në pamje të parë ashtu duket në fakt po të shohim matematikisht, por po të shohim dokumentacionin, ky shpenzim ndahet në tetë fatura dhe përbën shumën 92 775 lekë. Këto tetë fatura nga 1 – 7, janë me kuponë me faturë të fiskalizuar, me kupon tatimor të fiskalizuar, që nënkupton brenda ligjit fiskal dhe ka një detaj që këto janë të personalizuar. Në çfarë kuptimi? Këtu është shitësi që është me të gjitha gjeneralitetet e faturës dhe në pozicionin e blerësit thotë: blerësi: Emirjana Sako, me kartë identiteti, me kartën e saj, nga 1 - 7. Tani nëse ne jemi para kësaj situate, është e njëjta situate sikur unë të marr një kupon pa destinacion të shkoj në bankë dhe t’ia paguaj firmës “x”. Ndërkohë që unë kam marrë një kupon të personalizuar, që thotë: “ky shpenzim është kryer nga Emirjana Sako me këtë kupon të personalizuar”. Pra, është i njëjti koncept financiar në gjykimin tim. Në këtë kuptim, këto fatura nga 1 në 7 që përbëjnë shumën 77 000 e diçka, që duhen parë në këtë këndvështrim. Fatura nr. 8 që është një faturë e vodafonit 14 200 e ca lekë, diçka e tillë, mund të klasifikohet në kuptimin e këtij neni, se është pa

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 16, 19.01.2024*

destinacion, por nuk i kalon limitet e 500 000 lekshit. Nuk e di nëse isha i saktë teknikisht.

Z. I. Rusmali: Ju po flisni për shpenzime dhe pagesa.

Z. E. Lufa, përfaqësues i znj. E. Sako: Po!

Z. I. Rusmali: KQZ-ja flet për donacione.

Z. E. Lufa, përfaqësues i znj. E. Sako: Jo, kategorizimi i këtij shpenzimi kështu është kategorizuar, meqenëse e ka kaluar limitin.

Z. I. Rusmali: Ju po flisni për shpenzime.

Z. E. Lufa, përfaqësues i znj. E. Sako: Po!


Z. I. Rusmali: Në deklarimin që ka bërë Emirjana Sako në KQZ ka thënë: “I kam dhënë vetes time donacion 92 000 lekë në *cash*.”

Z. E. Lufa, përfaqësues i znj. E. Sako: Dhe këto janë financime të fushatës së saj nga burimet vetjake, nga rroga që parashikohet sipas këtij sipas vendimit nr. 13...

Z. K. Bele: Ka paguar 14 000 lekë telefonin e saj zonja?

Z. E. Lufa, përfaqësues i znj. E. Sako: Jo pa telefonin, nga 1 - 7 janë pagesa e fatura.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 16, 19.01.2024*

Z. E. Çefa: Si ka ndodhur dinamika? I ka marrë zonja *cash* ato para dhe i ka shpenzuar duke mos i futur në llogari?

Z. E. Lufa, përfaqësues i znj. E. Sako: Jo, zonja ka pasur të ardhurat e saj.

Z. E. Çefa: E qartë deri këtu.

Z. E. Lufa, përfaqësues i znj. E. Sako: Të ardhurat e saj, kuptohet të ardhura nga paga, po i bie shkurt. Normalisht në momentin që ajo bën një shpenzim për financim fushate, merr një kupon tatimor.

Z. E. Çefa: Edhe një herë pyetja është kjo: zonja Sako këto para që ka vendosur të përdorë nga të ardhurat e saj për fushatën, i ka marrë të gjitha nga rroga, i ka tërheq nga bankomati dhe i ka shpenzuar direkt? Apo i ka futur në llogarinë speciale?

Z. E. Lufa, përfaqësues i znj. E. Sako: Jo i ka shpenzuar direkt, por me fatura të personalizuar, ka marrë kuponat.

Z. E. Çefa: Po sigurisht që kuponat patjetër...

Z. E. Lufa, përfaqësues i znj. E. Sako: Por, që është i njejti koncept financiar.

Z. E. Çefa: Pretendimi i Komisionerit është pikërisht ky, që janë qarkulluar para në *cash*, jo nëpërmjet llogarisë. Ky është thelbi i shkeljes që pretendohet.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 16, 19.01.2024*

Z. E. Lufa, përfaqësues i znj. E. Sako: Atëherë unë jam dakord. Por ndoshta mund të jetë një precedent që nuk është bërë ndonjëherë ndoshta, sepse nëse do të dalim në një situatë tjetër, pra Emirjana Sako do të merrte 92 000 lekë, ose 77 000 lekë, do t'i depozitonte në bankë. Me këto lekë do të paguante këto shtatë fatura do të ishte në rregull. Por, është e njëjta gjë, se po me këto lekë, ka paguar po këto shtatë fatura. Këto janë me kupona të personalizuar që thonë: blerësi Emirjana Sako me nr. ID.... Pra, është e njëjta situatë e parë në dy këndvështrime në kuptimin tim.

Z. E. Çefa: Po!

Znj. J. Josifi: Në raportin financiar të dorëzuar nga kandidatja dhe të përfshirë në raportin financiar të subjektit zgjedhor pika 2/a "Të ardhura monetare", raporti është plotësuar sipas standarteve të miratuara nga Komisioni Rregullator thotë: "Statusi i dhuruesit: person fizik, emri i dhuruesit: Emirjana, mbiemri: Sako, adresa: Durrës, numri ID nuk po e lexojmë është numër personal, shuma e dhurimit: 92 775 lekë, datën e dhurimit nuk e ka shënuar, e ka lënë bosh. Metoda e dhurimit thotë: e ka deklaruar vet, para në dorë *cash*. Kaq po themi ne!

Z. E. Çefa: Pra, në diferencë nga zoti Muka...

Znj. J. Josifi: Eshtë burimi, pra jemi...

Z. E. Çefa: I cili i kishte depozituar këto para, që ja dhuronte vetes, në llogarinë speciale. Zonja Sako nuk e ka bërë diçka të tillë, apo jo? Kjo është diferenca?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 16, 19.01.2024*

Z. E. Lufa, përfaqësues i znj. E. Sako: Më falni këtu desha të ndërhyj për një moment edhe e mbylla. Por, kjo që nuk del aty, del te dokumentacioni, te faturat që janë të personalizuar.

Z. E. Çefa: Patjetër!

Z. E. Lufa, përfaqësues i znj. E. Sako: Ky është një precedent, prandaj thashë, një precedent që ndoshta nuk është parashikuar dhe nuk është bërë ndonjëherë. Mua më duket pak, në kuptimin financiar...

Z. E. Çefa: Qartë!

Z. E. Lufa, përfaqësues i znj. E. Sako: ...por po aty dalim, është e njëjta situatë. Fondet janë deklaruar sipas stadit ligjor në fuqi. Stadi fiskal. E njëjta gjë.

Z. I. Rusmali: Shuma totale e atyre tetë faturave rakordon me ...shtatë fatura janë 77 000 lekë. Shuma totale e tetë faturave është 92 000 lekë?

Z. E. Lufa, përfaqësues i znj. E. Sako: Shuma e faturave të personalizuar nga 1 - 7, që janë me kupon të personalizuar me faturë fiskale janë 77 000 lekë. Fatura nr. 8 që është një faturë nga vodafoni, që nuk ka destinacion, pra nuk është në stadin e këtyre faturave, nuk e kalon limitin prej 500 000 lekësh. Vetëm kjo duhet...

Z. I. Rusmali: Pse më thua për herë të dytë një gjë që ma ke thënë një herë. Po të pyes totali është 92 000 lekë? Apo është më pak, apo më shumë?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 16, 19.01.2024*

Z. E. Lufa, përfaqësues i znj. E. Sako: 92 000 lekë.

Z. I. Rusmali: Dakord!

Z. E. Çefa: Dakord, faleminderit! Atëherë përfaqësuesja e zotit Memolla.

*Znj. E. Memolla, përfaqësuese e z. Memolla: Faleminderit i nderuar! Jam Erinda Memolla, përfaqësuese e zotit Edison Memolla, në cilësinë e kandidatit për kryetar bashkie të Partisë Socialiste, për Bashkinë Rrogozhinë, në zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 mars 2022. Në kërkesën e Komisionerit thuhet se zoti Memolla në raportin e tij si kandidat i subjektit zgjedhor i Partisë Socialiste, i ka dhuruar vetes 120 592 lekë *cash*. Në këto kushte propozohet që të merret masa administrative në këtë shumë që sapo thamë. Ne e kundërshtojmë propozimin e Komisionerit, sepse po të vemë re, kur është plotësuar raporti me të dhënat financiare, përkatësisht shtojca 2, e KQZ-së, në seksionin 2/a “Të ardhura monetare dhe financime jo publike”, vemë re që zoti Edison Memolla i ka dhuruar vetes së tij shumën 9 590 lekë, që është shumë poshtë masës së përcaktuar nga ligji. Saktësisht në pikën 2, të nenit 92/2 të Kodit Zgjedhor. Ka edhe dhurues të tjerë të cilët janë: personi i parë me iniciale M. P. në shumën 73 500 lekë dhe donatori tjetër me iniciale K. H. në shumën 50 000 lekë. Këtu dua të ndalem pak më tepër, sepse po të veme re edhe ne raportin e plotësuar, dhuruesi i parë me iniciale M. P. është shënuar dhe në raport që i ka kryer të gjitha transaksionet me transfertë bankare. Për këtë ne kemi dhe pasqyrën financiare të marrë nga banka ku ndodhet llogaria e posaçme e kandidatit dhe gjithashtu edhe mandat pagesat. Ndërkohë, po të vemë re te donatori nr. 2 zoti K. H., i cili ka dhuruar shumën 50 000, këtu në raport shënohet që është bërë para *cash*, që i bie që është në kundërshti me ligjin. Për këtë pikë, ne kemi bindjen që*

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 16, 19.01.2024*

personi përgjegjës, i cili ka plotësuar raportin financiar të kandidatit, në mënyrë të paqëllimshme gjatë plotësimit të raportit në paisjen elektronike ka shënuar gabimisht para në *cash*, në vend të fjalës transfertë bankare. Ne e besojmë këtë veprim, sepse banka në pasqyrën e saj financiare ka shënuar të gjitha transfertat që janë bërë në llogarinë e kandidatit, gjithashtu vërtetohet edhe me mandat pagesat.

Z. E. Çefa: Keni marrë ndonjë kopje të këtyre tranfertave bankare që të na i paraqisni këtu?

Znj. E. Memolla, përfaqësuese e z. Memolla: Po!


Z. E. Çefa: Atëherë jepjani sekretarit! Vazhdoni, po ju ndjek. Përfundojeni fjalën!

Znj. E. Memolla, përfaqësuese e z. Memolla: Në këto kushte, ne e kundërshtojmë propozimin e Komisionerit, sepse kandidati nuk i ka dhuruar vetes shumën të cilën ju thoni. Dhurimi është *cash*, sepse është nën shumën e përcaktuar nga ligji. Ndërkohë për pjesën tjetër të dy dhuruesve, për njërin dhurues plotësimi është në rregull, ndërsa për dhuruesin tjetër ne e konsiderojmë gabim njerëzor nga pakujdesia dhe që nuk sjell asnjë dëm të qëllimshëm nga ana e personit përgjegjës për plotësimin e raportit. Kaq kisha, faleminderit!

Z. E. Çefa: Po faleminderit! Atëherë administrata, na sqaroni pak për pretendimet e përfaqësueses së zotit Memolla.

Z. Y. Merkaç: Në datat 31 mars, 14 mars 2022, Edison Memolla i ka dhuruar vetes 120 000 lekë.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 16, 19.01.2024*

Z. E. Çefa: Sipas vetëdeklarimit, sipas formularit?

Z. Y. Merkaç: 14 mars 2022!

Z. E. Çefa: Ndërkohë që pretendimi është që zoti Memolla i ka dhuruar vetes vetëm 9 000 e ...

Znj. E. Memolla, përfaqësuese e z. Memolla: Po të shohim në raport në pikën 2..., në pikën e të ardhurave financime jopublike, ndodhen të tre emrat e dhuruesve dhe po të shohim, emri Edison Memolla, ka këtë shumë përkatëse dhe është *cash*.

Z. E. Çefa: Të tre këto dhurime që ju citoni, çfarë shume kapin ju lutem?


Znj. E. Memolla, përfaqësuese e z. Memolla: Kapin shumën 133 090 lekë, të treja së bashku.

Z. Y. Merkaç: Ato janë dy formularë. Është pika 2/a dhe 2a "Të ardhurat monetare financimet jopublike", në dy faqe. Në një faqe është siç thotë përfaqësuesja. Në datën 14 mars 2022 i ka dorëzuar 9 500 lekë vetes dhe po në datën 14 mars është faqja tjetër, që deklaroi vetë zoti Memolla që ka deklaruar se i ka dhuruar vetes 120 592 lekë.

Z. E. Çefa: Pra, diskutohet vetëm për donacionin e dytë të tij po thoni?

Z. Y. Merkaç: Po, ajo është nën vlerën 50 000 lekë, nuk e kemi konsideruar.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 16, 19.01.2024*

Z. E. Çefa: Atëherë, përfaqësuesja e zotit Memolla, edhe një herë pyetjen ju lutem! Shuma 120 000 lekë është e vërtetë që është vetëfinancuar po e quajmë kështu, i përfaqësuari nga ju? Në shumën 120 mijë lekë. Jemi dakord me 9 000 e ca lekëshin, tani kemi këtë shifrën tjetër?

Znj. E. Memolla, përfaqësuese e z. Memolla: Tani dhe unë, nuk është se kam më tepër informacion për këtë. Unë di që nse kandidati ka marrë këtë shumë, e ka marrë nga llogaria e tij...

Z. E. Çefa: Personale?

Znj. E. Memolla, përfaqësuese e z. Memolla: Po!

Z. E. Çefa: Por a e ka depozituar në llogarinë e tij për efekt të zgjedhjeve?

Znj. E. Memolla, përfaqësuese e z. Memolla: Jo!

Z. E. Çefa: E ka shpenzuar *cash* praktikisht?

Znj. E. Memolla, përfaqësuese e z. Memolla: Po!

Z. E. Çefa: Dakord, pyetje të tjera nga kolegët? Nuk ka! Atëherë do të kalojmë...

Znj. J. Josifi: Mund të bëjmë edhe një sqarim përsa i takon sqarimit të dhënë për kandidaten Emirjana Sako, se paratë e dhuruara vetes në shumën 92 775 lekë,

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 16, 19.01.2024*

ndërkohë janë shpenzuar nëpërmjet shtatë faturave siç zotëria përmendi. Në raportin financiar të vetë kandidates ashtu siç ka deklaruar këtë shumë që ja ka dhuruar vetes me mënyrën *cash*, ka deklaruar ndërkohë në faqen pasardhëse edhe shpenzimet. Rezultojnë tetë zëra shpenzimesh të deklaruara nga ajo dhe përkatësisht nëse bëjmë shumën e këtyre tetë zërave koorespondojnë fiks me vlerën 92 775 lekë *cash*. Shtatë zërat e parë janë vënë në kategorinë e shërbimeve mitingje/tubime dhe aktivitete. Është deklaruar furnizuesi, emër mbiemër dhe të gjithë të dhënat e tjera, ndërkohë zëri i tetë thotë: “kategoria e shpenzimeve: media sociale, furnizuesi: ...”, kompania që zotëria përmendi, kompania e telekomunikacionit dhe nëse bëjmë të gjitha shumatat, të tetë mbledhorët na rezultojnë e njejta vlerë. Pra, sipas raportit financiar të dorëzuar nga kandidatja ajo ka pasur të ardhura të krijuara si pasojë e dhurimit që i ka bërë vetes në *cash* 92 775 lekë, të cilat të gjitha i ka shpenzuar në funksion të fushatës së saj si kandidatë. Pra, me një bilanc 0 në fund. Nuk është ky diskutimi. Diskutimi është që ky dhurim ka ndodhur jashtë sistemit bankar dhe është në vlerën mbi 50 000 lekë. Faleminderit!

Z. E. Lufa, përfaqësues i znj. E. Sako: Tani më falni dhe një sqarim?!

Z. E. Çefa: Patjetër!

Z. E. Lufa, përfaqësues i znj. E. Sako: Tani më vjen keq që e shihni në këtë këndvështrim. Unë e shoh në bazë të udhëzimit 13, që thotë: “financime nga burime vetjake të kandidatit”. Dhe burimet vetjake për shumën që paraqitet dhe për rrogën që ajo merr janë këto lloj dhurimesh. Tani këto janë të ardhurat e saj. Tani këto të ardhurat e saj, që i ka shpenzuar nga financim nga burime vetjake, këto ju i diskutoni dhurime. Këto nuk janë dhurime.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 16, 19.01.2024*

Z. E. Çefa: E kemi të qartë. Atëherë, termi përdorur është i dhurojnë vetes. Në fakt ky është vetëfinancim. Termi korrekt. Ajo ka financuar me lekët e saj, ka financuar aktivitetet. Tani diskutimi që bëhet i nderuar është ky, që nuk e ndalon njeri nën një limit të caktuar që ta vetëfinancojnë fushatën, absolutisht. Por, këtë financim duhet ta bëjë në rrugë zyrtare, në rrugë bankare, pra në rrugë të gjurmueshme. Ky është dhe pretendimi i Komisionerit!

Z. E. Lufa, përfaqësues i znj. E. Sako: Jam dakord, por pika që i referoheni ju thotë: “Nga burime të tjera”, nuk thotë “nga burime të vetë kandidatit”. Aty thotë nga burime të tjera dhe këto burime nuk janë burime të tjera, por janë të aksesueshme si burime të kandidatit që kanë kaluar një proces financiar të rregullt. Ky është se unë... Po ta shohësh thotë burime të tjera. Burime të tjera nuk shkon me këtë se janë dy gjëra në dy këndvështrime të ndryshme.


Z. E. Çefa: Pra, ju po thoni që dispozita nuk bën fjalë për vetëfinancimin, por bën fjalë për dhurime të mirëfillta nga të tretë...

Z. E. Lufa, përfaqësues i znj. E. Sako: Po, burime të mirëfillta nga të tjerë.

Z. E. Çefa: E kuptova! Pyetje nga kolegu?

Z. I. Rusmali: Për të gjithë këto kandidatët nga administrata ju lutem, ka ndonjë rubrikë të deklarami, për vetëfinancimin, rubrikë më vete? Sa kanë deklaruar si vetëfinancim?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 16, 19.01.2024*

Z. Y. Merkaj: Te modelet e miratuara nuk ka!

Z. I. Rusmali: Si?

Z. Y. Merkaj: Nuk ka te modelet e miratuara!

Z. I. Rusmali: Nuk ka formati, formulari nuk ka për vetëfinancim?

Znj. J. Josifi: Sepse nuk ka nevojë ta ketë për sa kohë përcakton emrin e dhuruesit, mbiemrin e dhuruesit. Pra, nëse te dhuruesi vendos po emrin tënd do të thotë që ky është vetëfinancim. Është e nënkuptuar. Është e ezauruar si skenar.

Z. I. Rusmali: Nuk është ashtu. Nuk mund të jetë ashtu.

Znj. J. Josifi: Ky është rasti pra. Të gjithë kandidatët si dhurues kanë deklaruar veten.

Z. E. Çefa: Sepse nuk kanë pasur alternativë që të deklarohin vetëfinancimin, a më kupton? Ai për të justifikuar ato lekë, për të qenë transparent me mënyrën e vet ka thënë ja dhurova vetes time.

Znj. J. Josifi: T'ia kishte kaluar me bankë, nuk ka asnjë problem.

Z. E. Çefa: Kjo është çështje tjetër.

Znj. J. Josifi: Kjo është çështje e nenit 173, pika 5.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 16, 19.01.2024*

Z. I. Rusmali: Sa është limiti i donacionit? Sa mund të jap unë donacion në fushatë?

Znj. J. Josifi: Një moment të lutem!

Z. E. Çefa: Po për kandidatët e tjerë që nuk janë prezent?

Z. I. Rusmali: Jo të lutem, mos ma hiq pyetjen!

Z. E. Çefa: Jo e kam me Yllin. Meqë zonja kërkon, Ylli na sqaron pak për kandidatët që nuk i kemi prezent. Psh për kandidatin e Shkodrës, si është situata pak a shumë? Pra, shkurt dhe ai i ka nxjerre nga xhepi, i ka shpenzuar, apo i ka futur në llogari si zoti Muka?

Z. Y. Merkaç: Janë në të njëjtat kushte të katërt kandidatët që kemi sjellë për të marrë masat administrative.

Z. E. Çefa: Qartë!

Z. Y. Merkaç: I ka dhuruar vetes 91 420 lekë *cash*, të ndarë në dy këste: 440 000 dhe 51 420 lekë.

Z. E. Çefa: Faleminderit!

Z. Y. Merkaç: Janë të katërt kandidatët.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksionëve*


Dt. 16, 19.01.2024

Znj. J. Josifi: Mundem atëhere? Është neni 92/1 “Shuma që çdo person fizik, ose juridik mund t’i japë një subjekti zgjedhor, përfshirë kandidatët e tij, nuk mund të jetë më e madhe se 1 milion lekë ose kundërvlera në sende, ose në shërbime. Vlera e shumës sipas fjalisë së parë të kësaj pike, indeksohet nga KQZ-ja çdo 5 vjet sipas normës së inflacionit”.

Z. E. Çefa: Dakord, faleminderit! Atëherë meqenëse debati i hetimit administrativ... po zoti Bele!

Z. K. Bele: Kjo është një pyetje që bëri zoti Rusmali, një argument që u ngrit më parë dhe nga zoti Rusmali. Lidhur me referencën ligjore, lidhur me nenin 23/4 i ligjit “Për Partitë Politike”. E kam për administratën e KQZ-së dhe ndoshta mund të reflektoni diçka para se të japim konkluzionet. Kreu III thotë “mjetet financiare dhe materiale të partive” dhe janë nga neni 15 deri te neni 24. Në nenin 15, pika 1 thotë: “dispozitat e këtij kreu rregullojnë financimin e partive politike nga burimet financiare materiale publike dhe jo publike, të cilat nuk rregullohen nga dispozitat e Kodit Zgjedhor”. Pra, specifikisht ligjvënësi ka thënë që, ky kre ka të bëjë me ato pika që nuk... Më tej nëse lexojmë nenet nga 15 te 24 megjithë ndryshimet në kuptueshmërinë time dhe e lexova me vemendje, nuk e kisha parë me kaq vëmendje më përpara. Në asnjë moment nuk flitet për financimin zgjedhor, por ka të bëjë me financimin periodik, vjetor, apo nuk e di si financohen partitë, në të gjitha këto nene. Ndërkaq po ky ligj ka një kapitull tjetër ku thotë: “mjetet financiare dhe shpenzimet e partive politike gjatë fushatës zgjedhore” dhe në 2020 ky është shfuqizuar. Të gjithë rregullimin për fushatën zgjedhore Kreu III, 1 “mjetet financiare dhe shpenzimet e partive politike gjatë fushatës zgjedhore”, në ligjin e partive.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 16, 19.01.2024*

Z. I. Rusmali: Po këto nuk janë shfuqizuar.

Z. K. Bele: Jo, këto nuk janë shfuqizuar, por këto referojnë, thonë këto janë të përdorshme për një aktivitet, për sa kohë që nuk i rregullon Kodi Zgjedhor. Në Kodin Zgjedhor kemi sanksionet në lidhje me financimet e fushatës. Pra, i bëra gjithë këto Ylli, për t'ju ftuar për të parë dhe njëherë këtë moment lidhur me sanksionin e kërkuar në aplikim të nenit 23, pika 4. Tani me thënë të drejtën na lindën këto diskutime.

Z. E. Çefa: Po zoti Braho!

Z. L. Braho: Në fakt dhe unë do të doja një sqarim nga administrata në lidhje me afatin, se po flasim për zgjedhjet e 6 marsit dhe jemi pothuaj dy vite me vonesë që kërkohet vendosja e këtyre gjobave. Mund të na e shpjegoni pak kështu, në hapa konkretë, kohorë, pse vjen kaq vonë propozimi për këtë gjobë? Mund të cënohet dhe parimi i sigurisë juridike kur tejkalohe afatet kështu. Pra, afatet që parashikon kodi, të paktën janë 30 ditë, 60 ditë që zgjat auditimi, ndërkohë ne këtu vijmë pas dy vitesh. Çfarë ka ndodhur gjatë gjithë kësaj kohe? Çfarë është bërë nga administrata e KQZ-së që vihet tani? Kush kanë qenë pengesat për ardhjen më parë të këtyre dënimeve administrative?

Z. Y. Merkaç: Thjesht ka qenë periudhë e ngarkuar për administratën e KQZ-së, nuk ka pasur kohë.


Z. E. Çefa: Dakord atëherë, përmbyllim hetimin dhe do të kalojmë në konkluzionet përfundimtare, duke filluar nga partitë politike. Zoti Sefa shkurtimisht të lutem!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 16, 19.01.2024*

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD: Përsa i përket pikës së parë të kërkesës të Komisionerit, që është pika 2, për Partinë Demokratike, që është ndarë në tre nënçështje. Shkelja e pretenduar sipas nenit 23/4, pika 3 e ligjit “Për Partitë Politike”, ne mendojmë që kjo kërkesë është e pabazuar në prova dhe në ligj. Në asnjë moment Partia Demokratike nuk ka refuzuar të bëjë transparente fondet e administruara gjatë buxhetit vjetor të dhënë nga buxheti i shtetit, përcaktuar në ligjin “Për Partitë Politike”. Gjithashtu nuk ka bërë asnjë tentativë për të mbajtur të fshehur, për të refuzuar, për të deklaruar. Siç përcakton qartë dhe dispozita nuk është nga ato dispozita që mund të zbatohet në rastet për shkelje të cilat ka pretenduar Komisioneri dhe administrata. Gjithashtu nuk u vërtetua në asnjë rast përdorimi i këtyre ambjenteve, në rast se kanë shërbyer për zyra elektorale apo jo. Ne kemi edhe një mendim që ka mbajtur dhe më parë kjo trupë, e cila ka referuar që zyrat e partive politike nuk konsiderohen si zyra elektorale dhe kjo është e qartë. Është një vendimarrje në fuqi dhe e pakundërshtuar nga asnjë palë dhe si rrjedhojë, kjo duhet të ishte marrë në konsideratë nga ana e administratës së KQZ-së. Gjithashtu nuk u vërtetua edhe fakti që këto zyra elektorale kanë qenë në funksion gjatë gjithë kohës se është bërë një intepretim i dyanshëm gjatë gjithë kohës. Gjithashtu në lidhje me shpenzimin e facebook-ut, nuk arrihet të evidentohet përsëri nga administrata në lidhje se si janë shpenzuar këto para. Mënyrën se si duhet të ishin deklaruar duke patur në konsideratë që edhe nga Partia Demokratike ka pas një problematikë në këtë periudhë, siç ju referuam dhe mësipër. Për shkeljen e pretenduar të dytë, që është në bazë të nenit 173, pika 3 e ligjit 1019/2008 e Kodit Zgjedhor, rezuton që Partia Demokratike brenda afateve të përcaktuara dhe në bazë të shkresës së ardhur nga KQZ-ja, ka depozituar raportin përfundimtar të shpenzimeve, i cili mban datën e pranimit në KQZ në datën 23.06.2022. Aty janë shpenzimet e raportuara nga Partia

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 16, 19.01.2024*

Demokratike, protokolluar me numrin 2775 prot., datë 23.06., përgjigjja thotë “në kuadër të shkresës datë 1.06.2022, gjeni dokumentacionin e kërkuar”. Brenda afatit të mundshëm ligjor kemi paraqitur dhe të gjithë shpenzimet e kryera për fushatë. Pika e tretë, që ka të bëjë me “nuk ka kthyer përgjigje”. Mund të qëndrojë, pavarësisht se ne mendojmë që kjo kërkesë nuk ka ardhur në dorën tonë, por është nisur në adresën zyrtare dhe normalisht quhet e njoftuar. Mendoj se kërkesa e Komisionerit duke i kërkuar Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve për të vendosur masë administrative ndaj Partisë Demokratike duhet të rrëzohet si një kërkesë e pambështetur në prova. E pambështetur dhe në ligj për këtë rast, pasi i është referuar një dispozite që nuk mund t’i referohet për rastin konkret për shkeljet që pretendohen, faleminderit!

Z. E. Çefa: Faleminderit zoti Sefa! Fjalën e ka përfaqësuesi i Partisë Socialiste.

Z. M. Legisi, përfaqësues i PS: Faleminderit i nderuar! Ne e vlerësojmë se Partia Socialiste në kuadër të zgjedhjeve të pjesshme vendore të datës 6 mars 2022, ka raportuar në mënyrë të saktë dhe të plotë të gjitha fondet e përfituara dhe të shpenzuara nga kjo parti në kuadër të kësaj fushate dhe çdo pretendim i bërë sipas kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve rezultoi, përveçse i pabazuar në ligj, rezultoi i pabazuar edhe në prova. Nga diskutimi që me të drejtë u diktua dhe nga dinamika e hetimit administrativ të zhvilluar nga Komisioneri rezultoi se nuk kishte një vullnet për të hetuar dhe për të saktësuar, apo për të marrë të dhëna plotësuese nga vetë subjektet. Vetëm foto na u paraqitën në bazën e provave që ishin ngritur pretendimet. Fotoja thjesht tregoi një pamje, një moment dhe një vend të caktuar në një kohë të caktuar por jo vijimësinë le të themi të pretendimit për një fakt, pra për përdorim zyre. Nuk kuptohet nëse është zyrë, është dyqan, apo së çfarë.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 16, 19.01.2024*

Përfundimisht, të nderuar, ne kërkojmë rrëzimin e kërkesës si të pabazuar në ligj dhe në prova, faleminderit!

Z. E. Çefa: Ju faleminderit! Zoti Nuri!

Z. F. Nuri, avokat për z. Ardian Muka: Po, faleminderit! Atëherë në lidhje me sanksionin e propozuar për ta vendosur ndaj kandidatit zotit Ardian Muka, të Koalicionit “Shtëpia e Lirisë” për zgjedhjet e 6 marsit 2022, ne i qëndrojmë vlerësimit se kjo është një kërkesë e pabazuar në ligj dhe në prova, ashtu sikurse rezultoi dhe nga shqyrtimi i çështjes këtu në KAS. Gjithashtu dhe nga provat që kandidati paraqiti nëpërmjet nesh, tre faturat përkatëse, por dhe shpjegimet. Provat e materialit bankar ku vërtetohet se origjina e parave të depozituara në llogarinë speciale të kandidatit, janë para të tërhequra po nga ai, nga një bankë tjetër, po atë ditë, sipas dokumenteve, arrihet të vërtetohet dhe të provohet qartë se këto nuk janë burime nga të tretë, por nga vetë kandidati. Janë burime të gjurmueshme, janë burime të ligjshme dhe nuk e shkelim aspak frymën e ligjit. Kështu që në këto kushte do t’ju kërkonim që të rrëzonit propozimin që ju ka ardhur për vendosjen e këtij sanksionit, faleminderit!

Z. E. Çefa: Faleminderit! Përfaqësuesi i zonjës Sako!

Z. E. Lufa, përfaqësues i znj. E. Sako: Faleminderit! Në përfundim kërkojmë, rivlerësimin e situatës, mbështetur në shpjegimet që dhamë më sipër, si dhe në prapësimet e depozituara pranë jush si dhe heqjen e gjobës për kandidaten zonjën Emirjana Sako, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 16, 19.01.2024*

Z. E. Çefa: Ju faleminderit! Përfaqësuesja e zotit Memolla!

Znj. E. Memolla, përfaqësuese e z. E. Memolla: Duke mos dashur të përsëris kolegët të cilët folën përpara meje, kërkoj mosmarrjen parasysh të propozimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, për të gjitha arësyet që fola më parë.

Z. E. Çefa: Ju faleminderit! Atëherë, duke parë kompleksitetin e çështjes, unë do t'ju kërkoj mirëkuptimin që të na jepni pak kohë dhe ne për të diskutuar një për një të gjitha këto propozime, që sigurisht nuk janë pak. Kështu që seancën për shpalljen e vendimit do t'jua njoftojmë në vijim. Për sot do ta ndërpresim këtu dhe jeni të gjithë të lirë të largoheni. Seancën për shpalljen e vendimit do t'jua komunikojmë paraprakisht nëpërmjet administratës së KQZ-së. Ju faleminderit, me kaq e deklarojmë të mbyllur këtë seancë!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 16, 19.01.2024*

19.01.2024

Ora, 13:33

RENDI I DITËS

“Për shqyrtimin e kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 01, datë 08.01.2024”.

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin Lako, z. Elvis Çefa, z. Ilirjan Rusmali, z. Koli Bele, z. Ledio Braho.
 - **Stafi KQZ:** Z. Y. Merkaj, znj. J. Josifi, z. E. Mema.
 - **Parti Politike:** S’ka prezent
 - **Të tjerë:** Bashkia Rrogozhinë (znj. E. Memolla)
Z. F. Nuri, përfaqësues i z. A. Muka
- KRIIK**

Z. E. Çefa: Mirëdita të gjithëve, deklarojmë të çelur seancën për shpalljen e vendimit të KAS, pas shqyrtimit të kërkesës nr. 01, datë 08.01.2024 të paraqitur nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. KAS pasi e shqyrtoi dhe diskutoi në tërësi çështjen vendosi:

- Pranimin e pjeshëm të kërkesës nr. 01, datë 08.01.2024 të paraqitur nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.
- Vendosjen e sanksionit administrativ gjobë në vlerën 100 000 lekë ndaj personit përgjegjës për financat në Partinë Socialiste të Shqipërisë, bazuar në pikën 1 të nenit 173 të Kodit Zgjedhor.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 16, 19.01.2024*

- Vendosjen e sanksionit administrativ gjorbë në vlerën 100 000 lekë ndaj personit përgjegjës për financat në Partinë Demokratike të Shqipërisë, bazuar në pikën 1 të nenit 173 të Kodit Zgjedhor.
 - Vendosjen e sanksionit administrativ gjorbë në vlerën 750 000 lekë ndaj subjektit Partisë Demokratike të Shqipërisë, bazuar në pikën 3 të nenit 173 të Kodit Zgjedhor.
 - Vendosjen e sanksionit administrativ gjorbë në vlerën 92 775 lekë ndaj zonjës Emirjana Sako, kandidate për kryetare bashkie e Partisë Socialiste të Shqipërisë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së, bazuar në pikën 5 të nenit 173 të Kodit Zgjedhor.
 - Vendosjen e sanksionit administrativ gjorbë në vlerën 120 590 lekë ndaj zotit Edison Memolla, kandidat për kryetar bashkie i Partisë Socialiste të Shqipërisë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së, bazuar në pikën 5 të nenit 173 të Kodit Zgjedhor.
 - Vendosjen e sanksionit administrativ gjorbë në vlerën 91 420 lekë ndaj zotit Bardh Spahia, kandidat për kryetar bashkie i Koalicionit “Shtëpia e Lirisë” dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së, bazuar në pikën 5 të nenit 173 të Kodit Zgjedhor.
 - Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
 - Kundër këtij vendimi, duke qenë se kemi të bëjmë me subjekte zgjedhore, lejohet të bëhet ankimi në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë brenda 30 ditëve nga shpallja e tij.
- U shpall në Tiranë, sot me datë 19.1.2024.
- Me kaq seanca deklarohet e mbyllur, faleminderit!

Vendimi nr. 07

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

